



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”

Tiranë 2023

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA	4
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT.....	4
2.1 Konteksti i problemit social.....	4
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
3. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	6
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	6
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
3.4 Pesha në buxhet.....	11
3.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	12
4. DETAJET E AUDITIMIT.....	13
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	13
4.2 Objektivi i auditimit.....	14
4.3 Pyetjet e auditimit.....	15
4.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
5. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT.....	16
5.1 A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?	16
5.2 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?.....	28
5.2.1 <i>Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira ?.....</i>	31
5.2.2 <i>A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit të procesit ?.....</i>	44
5.3 3 A janë përdorur kapacitetet njerëzore dhe financiare etj., në mbështetje të sistemit ?.....	54

Lista e shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1	RSH	Republika e Shqipërisë
2	BE	Bashkimi Evropian
3	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
4	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
5	MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
6	MD	Ministria e Drejtësisë
7	SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
8	QKTVDFH	Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje
9	DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
10	NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
11	OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
12	MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
13	ETN	Komiteti Drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor
14	KV	Koordinator Vendor
15	UMM	Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje
16	UM	Urdhër Mbrojtje
17	INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
18	EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
19	SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet
20	SSHKSH	Sistemi Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
21	REVALB	Regjistri Elektronik i Dhunës në Familje në Shqipëri

1. PËRMBLEDHJE

Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje është një përgjegjësi e përbashkët për shoqërinë, qeverinë, organizatat e shoqërisë civile dhe individët. Është e rëndësishme të punohet për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe më mbështetës për viktimat dhe për të parandaluar dhunën në familje në të ardhmen nëpërmjet, sigurimit të zbatimit të ligjit, ofrimit të kujdesit të nevojshëm mjekësor, ndërgjegjësimit të publikut dhe edukimit të vazhdueshëm për të sensibilizuar opinionin në inkurajimin e raportimit të rasteve të dhunës, mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së viktimave, përfshirjen e viktimave në procesin vendimmarrës, trajnimit të vazhdueshëm të personelit që trajton rastet e dhunës dhe jo vetëm.

Objekti i këtij auditimi ka qenë, vlerësimi mbi efektivitetin e sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus gratë e dhunuara, për periudhën objekt auditimi Janar 2020 - Qershor 2023. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij ka një qasje të kombinuar, duke parë nga perspektiva e funksionalitetit që institucionet qendrore të ngarkuara kanë në lidhje me hartimin, zbatimin e politikave por dhe implementimin e tyre, si dhe rolin e njësive të varësisë në këtë drejtim. Rëndësi iu kushtua bashkëpunimit midis aktorëve qendrorë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore lidhur me implementimin e politikave kombëtare për dhunën në familje, në vijim procesit të decentralizimit të shërbimeve shoqërore drejt këtyre të fundit. Gjatë këtij auditimi u fokusua në disa institucione në të dy nivelet e qeverisjes, atë qendrore dhe vendore, kjo për të patur një panoramë më të plotë lidhur me politikat e ndërmarrja, implementimin e tyre, koordinimin ndërmjet strukturave dhe krahasimin e qasjes që ato kanë në varësi të përgjegjësisë dhe specifikave që mbulojnë. Auditimi u orientua në disa kolona bazë si, plotësia e kuadrit ligjor ekzistues në marrjen e masave parandaluese për dhunën në familje, funksionimi i sistemit të ngritur për trajtimin e viktimës nga momenti i denoncimit të tij dhe ecurinë në vijim, mënyra si kryhet monitorimi mbi sistemin si dhe mbështetja buxhetore në funksion të tyre. Në vlerësimin tonë si auditues të jashtëm të pavarur, masat e marra nga institucionet përgjegjëse kanë qenë pjesërisht efektive. Implementimi i politikave të hartuara për dhunën në familje, nga ana e institucioneve përgjegjëse ka qenë i pamjaftueshëm në garantimin e një sistemi i cili duhet të përgjigjet në mënyrë të shpejtë dhe konsistente qytetarit, viktimë e dhunës në familje. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e autoritetit kryesor, e shoqëruar nga mungesa të theksuara kapacitetesh në strukturë si dhe pa një kuadër detyrues ligjor për institucionet e tjera pjesëmarrëse në sistem, nuk ka arritur të përmbushë plotësisht rolin e saj. U evidentua koordinim i dobët mes institucioneve, monitorim i pamjaftueshëm i tyre, mosfunksionim i sistemeve informatike për regjistrimin dhe monitorimin e rasteve dhe shërbimeve të përfituara si dhe problematika lidhur me to, mungesë e qartësisë së duhur në nivel qendror dhe vendor mbi masën dhe mënyrën e financimit të shërbimeve, mungesë kapacitetesh akomoduese dhe standardesh lidhur me to, ndryshime të shpeshta të strukturore kryesisht të Policisë së Shtetit për funksionet që lidhen me dhunën në familje, mungesë e figurës së psikologut në trajtimin e rastit etj, të cilat ndikojnë/kanë ndikuar në efektivitetin e sistemit të ngritur. Në përfundim janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

2.1 Konteksti i Problemit Social

Dhuna ndaj grave, masat për parandalimin e saj dhe rehabilitimi i viktimave nga dhuna është një problem i qenësishëm në shoqërinë e vendit tonë. Politikat e miratuara kanë për qëllim kryesor të sigurojnë ndryshim afatgjatë të sjelljes dhe kulturës së shoqërisë ndaj këtij fenomeni dhe ofrimit të gjitha shërbimeve të nevojshme ndaj viktimave të dhunës. Në bazë të Vrojtimit më

të fundit kombëtar të zhvilluar nga INSTAT¹ në vitin 2019, 1 në 2, apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç, kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës² gjatë jetës së tyre. Ndërkohë që, dhuna në familje mbetet forma më e përhapur. Gjatë tre viteve të fundit pranë institucionit të Policisë së Shtetit regjistrohen çdo vit rreth 5,000 raste dhunës në familje, kjo me një tendencë të qëndrueshme.

Masat e marra dhe bashkëpunimi ndërinstitutional i të gjithë institucioneve përgjegjëse, kanë për qëllim të krijojnë një shoqëri të lirë nga dhuna në familje. Përmeshja e këtij qëllimi është mision dhe përfaqëson një faktor themelor për krijimin e një shoqërie të shëndoshë dhe paqësore dhe ndikon drejtpërdrejt në edukimin e brezave të shoqërisë dhe shndërrimin e familjes në një bërthamë të rëndësishme të edukimit shoqëror. Është shumë e rëndësishme që objektivat e shtetit tonë dhe shoqërisë të përmbushen si në zbatim të ligjit dhe në kontributin që jep shoqëria shqiptare për rehabilitimin e viktimave.

Përmeshja e objektivave, si: parandalimi i dhunës në familje, luftimi i saj, si dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje në të gjitha format me të cilat ajo shfaqet bëhet përmes masave të veçanta, të cilat janë të parashikuara nga vetë ligji ose masa të tjera të nevojshme që ndërmerren rast pas rasti nga institucionet përkatëse. Nga këto institucione dhe shoqëria vijnë përpjekjet për të sfiduar këtë mentalitet e për të mos e konsideruar më dhunën në familje vetëm si “*problem i atyre që iu ndodh*” por si një shqetësim e problem i gjithë shoqërisë, ku secili(a) të ndiejë dhe zbatojë përgjegjësitë e tij(saj) si qytetar i kësaj shoqërie.

Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, përmes masave të veçanta për kategoritë që kërkojnë mbrojtje të veçantë me ndryshimet ligjore të vitit 2020, sollën në vëmendje edhe gratë e vajzat si kategori të posaçme, të cilat ligji i mbron në mënyrë të veçantë. Përfshirja në këtë kategori ka pasur për qëllim të përafrojë më tepër këtë ligj, me Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit). Në aspektin social, viktimat e dhunës si pjesë e shoqërisë shqiptare dhe që gëzojnë të drejtat e tyre për mbrojtje e rehabilitim, mbështetet nga shteti me legjislacionin përkatës i cili ka parashikuar si legjislacion të zbatueshëm Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW) si dhe Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (CAHVIO) (neni 3/1.1 të ligjit). Në këtë këndvështrim, të gjitha autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit si dhe gjykatat, marrin në konsideratë masat e parashikuara në këto Konventa për mbrojtjen e grave e të vajzave. Kjo është në vëmendje për faktin se këto Konventa janë të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe kanë fuqi mbi ligjet.

Shteti shqiptar dhe shoqëria nëpërmjet organizimeve të ndryshme ka për detyrë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe përkrahjen e tyre deri në rehabilitimin e plotë të tyre në shoqëri me të drejtat që gëzon nga zbatimi i ligjit dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Është detyrë e institucioneve përkatëse që janë pjesë e zinxhirit të këtij procesi që nga referimi e deri në rehabilitimin e plotë t’ju sigurojnë kushte sa më të pranueshme e lehtësuese për vazhdimin e jetës në aspektin social dhe në atë ekonomik dhe të strehimit.

Institucionet kanë një rol aktiv të dyfishtë: mbrojtës dhe parandalues si mënyra e vetme e komunikimit institucional në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së pjesëtarëve të familjes nga ky fenomen shkatërrimtar që ndodh në atë që është qeliza bazë e shoqërisë dhe që rrezikon të sjellë impakt negativ të veçantë në formimin dhe edukimin e brezit të ri nëse, nuk merren masat e duhura dhe në kohë.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të

¹ <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>

² - dhuna në familje e ushtruar nga partneri, dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore, dhuna nga jo-partneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja.

audituar. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfytes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmoi auditimin “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”, duke e konsideruar një çështje të rëndësishme dhe me ndjeshmëri të lartë sociale. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me sistemin e ngritur për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe efektivitetin e mekanizmit të ngritur në funksion të zbatimit të tyre. Në përfundim janë dhënë rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë si më poshtë:
 - ✓ Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoritë Rajonale sipas rastit
 - ✓ Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje
2. Ministria e Drejtësisë
3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë sipas rastit
4. Këshilli i Qarkut Tiranë
5. Bashkia Durrës
6. Bashkia Gjirokastrë
7. Bashkia Kukës

Ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare³ është baza e funksionimit të sistemit të ngritur në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme. Ai gjithashtu ka për qëllim garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁴, është autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Në cilësinë e institucionit qendror MSHMS ka për mision, ndër të tjera, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.⁵

³ Kreu I, neni 1, Ligji nr. 9669, 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

⁴ Kreu II, neni 2, pika 1, Ligji nr. 9669, 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

⁵ VKM nr. 508, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Në përmbushje të këtij roli, kjo ministri, nëpërmjet veprimtarisë së saj kontribuon, ndër të tjera, në:

- ✓ hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ✓ financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ✓ mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës (...);
- ✓ organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
- ✓ bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nën-komisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave;
- ✓ licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;
- ✓ ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje;
- ✓ koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore etj.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kryen këto detyra në bashkëpunim me institucionet përkatëse të varësisë në fushën e dhunës ndaj grave, si Shërbimi Social Shtetëror dhe Qendra Kombëtare e Trajtimin të Viktimave të Dhunës në Familje.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit së bashku me strukturat e varësisë, si njësi e Ministrisë së Brendshme, është organi që ka për detyrë ti përgjigjet çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose/dhe në rastet e shkeljes së urdhrin të mbrojtjes/urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, të fillojnë hetimet kryesisht, si dhe të bëjnë referimet në drejtim të hallkave institucionale përkatëse për trajtimin e rasteve.

Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për:

- ✓ trajnimin e ekspertëve mjeko - ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- ✓ marrjen e masave për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;
- ✓ bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;
- ✓ mbikëqyrjen e funksionimit të sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- ✓ bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

- ✓ hartimin e formularëve të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;
- ✓ sigurimin e zbatimit të detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko - ligjor dhe psikiatro - ligjor (nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

Bashkitë Durrës, Gjirokastrë, Kukës, në cilësinë e njësisë e vetëqeverisjes vendore, kanë për detyrë:

- ✓ angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;
- ✓ ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;
- ✓ ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;
- ✓ marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligj zbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;
- ✓ marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;
- ✓ bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Këshilli i Qarkut Tiranë, në cilësinë e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore, është institucioni i ngarkuar me ndërtimin dhe zbatimin e politikave rajonale, harmonizimin e tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.⁶

3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

3.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
- Deklarata dhe Platformën për Veprim të Pekinit;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje” (Konventa e Stambollit);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025;
- Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligji 22/2018 “Për strehimin social”;

⁶ Neni 31, pika 1, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligji 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Të tjera.

3.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 733 datë 20.10.2016, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit 2016–2020”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 400 datë 30.06.2021, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social” ;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.03.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”;
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 912, datë 27.12.2018 “Për miratimin e modelit dhe procedurave për Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”;
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme nr. 866 datë 20.12.2018, “Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje”;
- Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 9, datë 17.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”;
- Të tjera.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

-Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me veprimtarinë e saj në fushën e mbrojtjes sociale dhe në veçanti në fushën e dhunës në marrëdhëniet familjare ka një rol thelbësor politik bërës, pasi ajo ka hartuar dhe monitoruar në vite strategjitë e miratuara për Barazinë Gjinore. Si autoritet përgjegjës, kjo ministri kryen rol koordinues dhe bashkërendues mes institucioneve pjesë të mekanizmit që garantojnë mbrojtjen me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme në rastet e dhunës në familje. Gjithashtu, financon dhe bashkë financon mbi bazë projektesh NJVQV-të me fonde të Fondit Social, për krijimin e shërbimeve në mbështetje të viktimave të dhunës në familje.

-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me strukturat e saj të varësisë siguron funksionimin në nivel qendror dhe vendor të mekanizmit kombëtar të referimit sa i takon mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrin të mbrojtjes/urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Strukturat e policisë në shumë raste janë “porta e parë” e mekanizmit ku drejtohen viktimat e dhunës në familje për të kërkuar ndaljen e dhunës dhe marrjen e masave ndaj dhunuesit. Nëpërmjet ndihmës - specialistëve të policimit në komunitetet, zyrave policore, patrullave të përgjithshme të policisë, komisariatet etj, sigurohet që viktimat e dhunës të marrin ndihmën fillestare.

-Ministria e Drejtësisë nëpërmjet veprimtarisë së saj siguron trajnimin e përshtatshëm për profesionet mjeko - ligjore, psikiatro - ligjore dhe përmbaruesve gjyqësor lidhur me çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo ministri gjithashtu siguron dhe mbikëqyr ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës në familje, si dhe garanton bashkëpunimin me institucione të tjera të sistemit të drejtësisë lidhur me unifikimin e praktikave për trajtimin e rasteve.


-Njësitë e vetëqeverisjes vendore me veprimtarinë e tyre vendosin në funksion shërbimet e dedikuara në përfitim të viktimave të dhunës në familje qofshin ato rezidenciale, ditore, multifunksionale, qendra emergjence etj, me qëllim mbështetjen e viktimave dhe largimin e tyre nga dhunuesi. Në këto institucione gjen zbatim konkret mekanizmi kombëtar i referimit të rasteve të dhunës, nëpërmjet krijimit të komiteteve drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; ekipet teknike ndërdisiplinore (ETN); koordinatorët vendorë të dhunës (KVDH).

VKM nr.327 datë 02.06.2021 përcakton mënyrën se si do të funksionojë mekanizmi i koordinuar i referimit i cili duhet të ngrihet pranë çdo Bashkie ku duhet të përfshihen:

- ✓ Komitetet Drejtuese, me përbërje me përfaqësues të institucioneve në nivel vendor.
- ✓ Ekipet Teknike Ndërdisiplinore me përfaqësues teknikë nga disa institucione vendore.
- ✓ Koordinatorët vendorë me punonjës të strukturës së bashkisë të dedikuar për rastet e dhunës).

Të tre këto struktura kanë një rol të rëndësishëm në proces për vetë faktin e koordinimit ndër-institucional dhe përgjigjes sipas fushave të përgjegjësisë. Rol kyç në proces ka Koordinatori Vendor i cili është hallka kryesore që bashkërendon përgjigjen institucionale dhe ndjek në vazhdimësi rastin. Në mënyrë skematike procesi paraqitet si më poshtë:

Figura nr. 1 Skema e funksionimit të mekanizmit në nivel vendor



Burimi: Grupi i auditimit

3.4 Pesha në buxhet

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet programit buxhetor 10430 “Përkujdesi Social”. Ky program mbështet nëpërmjet pagesave shërbimet sociale dhe përfshirjen e barabartë sociale dhe ekonomike të burrave, grave, fëmijëve dhe grupeve të marginalizuara. Fondet për përkujdesjen shoqërore dhe integrimin e grave të dhunuara në marrëdhëniet familjare, të cilat janë vendosur aktualisht në fokus të auditimit, janë pjesë e dy produkteve kryesore buxhetore, “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike” dhe “Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social”.

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike përfitojnë nga fonde nga buxheti i shtetit nëpërmjet programit buxhetor të MSHMS “Përkujdesi Social”. Nga fondet e këtij programi veçohen fondet vjetore të përfituara nga:

Qendra e Trajtit të Viktimave të Dhunës në Familje me vend ndodhje në Kamzë është institucioni kryesor në rang kombëtar që kryen shërbim të drejtpërdrejtë për gratë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror si institucion epror por edhe kontrollues për standardet dhe financimet në ofrues të tjerë shërbimesh për viktimat e dhunës në familje por jo vetëm.


Tabela nr.1 Fondet buxhetore të institucioneve në varësi të MSHMS

Në lekë

Institucioni	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
QTVDF	21,932,880	21,670,988	22,735,294
SHSSH	70,462,152	67,049,152	83,600,389

Burimi: MSHMS përpunuar nga grupi i auditimit

Figura nr. 2 Skema e funksionimit të financimeve buxhetore të MSHMS



Burimi: Grupi i auditimit

Fondi Social është mekanizëm financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Këshilla Qarku dhe Bashkitë e vendit për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruuese në territorin që mbulojnë, apo krijimin e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave social. Fondet buxhetore nga NJVQV-të përfitohen pas miratimit të projekteve të paraqitura në MSHMS. Shpërndarja e tyre paraqitet si vijon:

Tabela nr.2 Fondi social dhe institucionet përfituese

Në lekë

Viti	Fonde gjithsej	Këshilla Qarku	Bashki
2023	145,110,817	6	12
2022	158,818,000	6	21

2021	147,894,616	6	16
------	-------------	---	----

Burimi: MSHMS përpunuar nga Grupi i auditimit

Ministria e Drejtësisë fondet e alokuara nga buxheti të cilat lidhen me gratë e dhunuara kalojnë nëpërmjet programit buxhetor 1130 “Mjekësia Ligjore”, 3310 “Ndiurma juridike falas” dhe “Shërbimi Përmbarimor”. Më poshtë paraqiten të dhënat buxhetore përkatëse:

Tabela nr.3 Fondet buxhetore të MD sipas viteve

në 000/ Lekë									
Kodi programit	Emërtimi i programit	Treguesi i performances	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023 4-mujori I-re
			nr.	Buxheti	nr.	Buxheti	nr.	Buxheti	nr. Buxheti
1130	Mjekësia Ligjore	Akte skspertimi për raste të dhunes seksuale					78	1,775	- -
3310	Ndiurma Juridike Falas	Nidhmë juridike falas për gratë dhe vajzat në nevojë	323	6,793	944	15,700	679	6,877	303 2,887
3350	Shërbimi Përmbarimor	Ekzekutim urdhra mbrojtje për gratë e dhunuara	360	3,017	763	6,073	1,040	15,402	579 8,500
Totali				9,810		21,773		24,054	11,387

Burimi: MD

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke qenë se në veprimtarinë e saj, mbulon një sërë veprash, nuk mund të bëjë një ndarje e fondeve të parashikuara dhe atyre të shpenzuara.

3.5 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit

Gjatë zhvillimit të auditimit, institucionet përgjithësisht i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese si edhe kërkesave për informacion dhe dokumentacion të grupit të auditimit. Vlen të theksohet disponibiliteti dhe korrektësia e strukturave qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit lidhur në kthimin e përgjigjeve dhe bashkëpunimin gjatë gjithë procesit auditues, në lidhje me kërkesat dhe takimet konsultuese të grupit të auditimit mbi temën e auditimit. Ndërkohë bashkëveprimi më i dobët gjatë auditimit u evidentua me strukturat e Bashkisë Gjirokastrë, kjo si rezultat i disa vonesave dhe mangësive në dërgimin e informacionit, çka kërkon më tepër vëmendje dhe angazhim nga këto struktura në vijim.

4. DETAJET E AUDITIMIT


4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e sigurisë kibernetike. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më efikas të një problemi kompleks në rastin e sistemit të ngritur në funksion të parandalimit, përgjigjes dhe rehabilitimit të pasojave sociale, rrjedhojë e dhunës në familje. Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Figura nr. 3 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela nr. 4 Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Mos përfshirja e përshtatshme e masave të parashikuara nga Konventat Ndërkombëtare në aktet strategjike vendase.	Risk Strategjik	I lartë
2	Zbatim dhe monitorim jo i plotë i strategjive të hartuara.		I lartë
3	Mos përfitim fondesh i NJVQV-ve nga Fondi Social i buxhetit të shtetit.	Risk Financiar	I lartë

4	Mungesë analize për planifikimin e fondeve buxhetore.		I mesëm
5	Iniciativa ligjore të papërfunduara me impakt dhe Akte rregullative të papërditësuara.	Risk Rregullator dhe Juridik	I mesëm
6	Kufizim në përdorimin e infrastrukturës TIK.	Risk Operacional	I mesëm
7	Mungesë e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës.		I lartë
8	Numër i limituar i fushatave ndërgjegjësuese.		I mesëm
9	Koordinim dhe bashkëveprim i pamjaftueshëm mes aktorëve në proces.		I lartë
10	Mos përmbushja e detyrimeve prej institucioneve përgjegjëse mbi masat që duhet të ndërmerren dhe kohën e implementimit.		I lartë
11	Monitorim jo i plotë i proceseve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shërbimeve të ofruara.		I lartë


Burimi: Grupi i auditimit

4.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”, kishte si objektiv kryesor vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre në funksion të garantimit të mbrojtjes, mbështetjes, rehabilitimit dhe parandalimit të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare. Në këtë mënyrë është siguruar një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse politikat e ndërmarra, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta si dhe proceset administrative të ndërmarra garantojnë mirëfunksionimin e këtij sistemi.

4.3 Pyetjet e auditimit

Figura nr.4 Piramida e pyetjeve audituese



4.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim kishte si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi politikat e ndërmarrja dhe mirë administrimin e proceseve me synim marrjen e masave të përshtatshme. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij kishte një qasje të kombinuar në nivel sistemi duke e parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë për gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare, në lidhje me masat parandaluese, garantimin e mbrojtjes së nevojshme, trajtimin në vijimësi si dhe ri-integrimin social të tyre.

Periodha e auditimit ishte 01.01.2020 deri më datë 30.06.2023. Gjatë këtij auditimi ne u fokusuam në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dy institucione në varësi të saj Shërbimin Social Shtetëror dhe Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Bashkitë, Durrës, Gjirokastrë, Kukës si dhe Këshillin e Qarkut Tiranë. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periodha e auditimit ishte për të patur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara, funksionimin e mekanizmit të ngritur si dhe aktivitetin real që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave.

5. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: A i përgjigjet sistemi aktual në mënyrë të përshtatshme rasteve të grave të dhunuara në marrëdhëniet familjare ?

Mesazhi i auditimit

Institucionet shtetërore të angazhuara kundër dhunës në familje është e nevojshme të bëjnë hapa përpara për promovimin e barazisë gjinore, për të siguruar një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë, pavarësisht nga gjinia.

Dhuna në familje si një nga problematikat më të ndjeshme me të cilën po përballen shoqëria shqiptare sot, paraqitet me një numër të lartë të rasteve të denoncuar në institucionet e shtetit. Kjo tregon një ndërgjegjësim gjithnjë e më të lartë shoqëror por gjithashtu rrit përgjegjësitë që shteti duhet të mbarti nëpërmjet mekanizmave të tij për të garantuar jetën dhe shëndetin e grave dhe vajzave, viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Mekanizmi i ngritur në nivel kombëtar për dhunën në familje nuk ka arritur t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme rasteve të paraqitura, çka paraqet nevojën për një vlerësim të qartë dhe objektiv të situatës nga të gjithë aktorët e përfshirë, përmirësim të proceseve ekzistuese si dhe marrjen e masave të përshtatshme, për përgjigjen në mënyrë të denjë qytetarëve në nevojë, dhe për të mbështetur në tejkalimin e problematikave të tyre sociale.

5.1 Pyetje e auditimit: A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?

Kuadri ligjor, institucional dhe politikat mbështetëse për nevojat e viktimave të dhunës në familje (DHF) dhe dhunës me bazë gjinore (DHBGJ)

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një nga shkeljet më të përhapura, të vazhdueshme dhe shkatërruese e të drejtave të njeriut. Pabarazia gjinore vazhdon në mbarë botën. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave do të kërkojë në vijimësi përpjekje më të fuqishme, duke përfshirë kuadrin ligjor, për të luftuar diskriminimin me bazë gjinore, që shpesh

vjen si rezultati qëndrimeve patriarkale dhe normave shoqërore. Mosndëshkimi, heshtja dhe stigma, kanë lejuar që dhuna kundër grave të përshkallëzohet në përmasa të mëdha, ku një në tri gra në mbarë botën përjetojnë dhunë gjatë jetës.

Qeveria shqiptare nëpërmjet organizmave të ndryshme shtetëror dhe shoqëria civile ka për detyrë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe përkrahjen e tyre deri në rehabilitimin e plotë të tyre në shoqëri me të drejtat që gëzon nga zbatimi i ligjit dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Institucionet shtetërore pjesë procesit të MKR dhe rehabilitimit, detyrohen të sigurojnë kushte sa më të pranueshme e lehtësuese grave të dhunuara, për parandalimin, vazhdimin e jetës në aspektin social, ekonomik dhe të strehimit, ku problematika e tyre është analizuar më poshtë në këtë Projekt auditimi.

Institucionet kanë rol aktiv të dyfishtë mbrojtës dhe parandalues, si mënyra e vetme e komunikimit institucional në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së pjesëtarëve të familjes nga ky fenomen shkatërrimtar, që ndodh në atë që është qeliza bazë e shoqërisë dhe që rrezikon të sjellë impakt negativ të veçantë në formimin dhe edukimin e brezit të ri nëse, nuk merren masat e duhura dhe në kohë.

Përpjekjet e vazhdueshme për harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, kanë evidentuar çështje të diskriminimit gjinor, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, jo vetëm në ligjet e veçanta që u përkasin këtyre çështjeve, por edhe në legjislacionin shqiptar në tërësi.

Referuar treguesve të INSTAT7 në vitin 2019(Vrojtim), evidentohet se 1 në 2, apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç, kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës8 gjatë jetës së tyre dhe sipas raporteve të gjatë tre viteve të fundit(2021-6 muji 2023) pranë institucionit të Policisë së Shtetit janë regjistruar rreth 5,000 raste/vit të dhunës në familje.

Për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës në familje Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në krijimin e kuadrit përkatës ligjor, institucional dhe të politikave, në zbatim dhe të nënshkrimit dhe ratifikimit të traktateve detyruese ndërkombëtare, të cilat garantojnë barazinë e burrave dhe grave dhe ndalojnë diskriminimin me bazë gjinore, siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), Axxhenda 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) ku OZHQ synon barazinë gjinore, etj.

Realizimi në masën 80% i qëllimeve, objektivave dhe veprimeve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016–2020, siç është evidentuar nga vlerësimet e kryera, në kushtet e përballimit të emergjencës civile të tërmetit të fund vitit 2019, apo të gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19 në vitin 2020, kanë treguar se ekzekutivi ka adresuar në mënyrën e duhur, të gjitha çështjet prioritare për barazinë gjinore⁹. SKBGJ 2021-2030 reflekton gjithashtu edhe lidhjen e drejtpërdrejtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm⁴ (OZHQ) dhe të Axxhendës 2030⁵. Po kështu, masat dhe veprimet e parashikuara në këtë strategji ndërthuren apo lidhen dhe me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020-2025⁶ të Bashkimit Evropian, të specifikuar më tej në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, publikuar në 25 Nëntor 2020¹⁰. Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje dhe avancimi drejt eliminimit të tyre nuk mund të realizohet pa një shoqëri me mendësi të hapur, që lufton stereotipet gjinore e

⁷ <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>

⁸ - dhuna në familje e ushtruar nga partneri, dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore, dhuna nga jo-partneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja.

⁹ SKBGJ vitit 2021-2030 faqe 3

¹⁰ SKBGJ vitit 2021-2030 dhe Plan veprimi për BGJ (GAP III)

praktikat e dëmshme si dhe që nuk e toleron ushtrimin e dhunës. Prandaj një sërë masash e veprimesh nën këtë qëllim strategjik fokusohen pikërisht tek informimi, ndërgjegjësimi dhe krijimi i brezit të barazisë.¹¹

Legjislacioni për Dhunën ndaj grave (DHNGV) është shumë i rëndësishme dhe kryen funksion rregullator në marrëdhëniet që krijohen viktimave, që nga ndodhja, referimi e deri tek rehabilitimi i tyre. Sipas një studimi (Dhuna ndaj grave dhe vajzave, studim 2018 e UNDP) Përveç pranimi të DHNGV-së si një problem madhor në Shqipëri, në tabelë 5.5 tregohet se 83% e grave të grup moshës 18-74 vjeç, mendonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesat/ familjet e tyre dhe 81,9% mendonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet seksuale dhe përdhunimi.

Tabela nr. 5 Rëndësia e ekzistencës në Shqipëri të ligjeve për dhunën në familje dhe dhunën seksuale (Të dhëna të ponderuara)

Kampioni	
Sa e rëndësishme është që në Shqipëri të gjithsej	
ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesat/familjet e tyre? %	
N=1.040.726	
Shumë e rëndësishme	83,5%
E rëndësishme	15,4%
Nuk është e rëndësishme	1,1%
Nuk e di	,4%
Sa e rëndësishme është që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet seksuale/përdhunimi?	
Shumë e rëndësishme	81,9%
E rëndësishme	16,7%
Nuk është e rëndësishme	,9%
Nuk e di	,4%

Burimi: Studim i vitit 2018

Me marrjen e statusit kandidat për anëtarësim në BE në qershor 2014, Shqipëria ka ndërmarrë dhe zbatuar pjesërisht një seri reformash që janë hapa domethënës në procesin e aderimit në BE. Barazia gjinore është gjithashtu, një kërkesë kryesore për tërësinë e legjislacionit të BE-së dhe Qeveria e Shqipërisë e ka përmirësuar vazhdimisht kuadrin e saj ligjor për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje, duke e përafruar atë me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me hapjen e procesit të stabilizim-asocimit në BE, legjislacioni për dhunën në familje ka pësuar ndryshime dhe është përafruar shumë me legjislacionin evropian, Në përgjigje të Raportit të Vlerësimit të GREVIO-s dhe në përputhje me rekomandimet e organeve ndërkombëtare, Parlamenti shqiptar ka votuar unanimisht një rezolutë që dënon DHNGV-në dhe u bën thirrje autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, të ndërmarrin veprime konkrete për të zbatuar në mënyrë efikase legjislacionin për parandalimin dhe eliminimin e DHNGV-së.

Në vitin 2018, ndryshimet në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” përmirësuan përkufizimin ligjor të dhunës në familje në përputhje me Konventën e Stambollit dhe CEDAW.

¹¹ SKBGJ vitit 2021-2030 faqe 34

Është ngritur kuadri ligjor dhe nënligjorë, politikat dhe planet e veprimit me fokus të veçantë në barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje të miratuara në fusha të ndryshme, të cilat nuk janë një listë shteruese në fushën e Barazinë gjinore dhe Dhunën ndaj grave e vajzave, Konstatohet se fokusi është më shumë në avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave të cilat përfshijnë sigurimin e mbrojtjes menjëhershme për gratë dhe vajzat dhe anëtarët e tjerë të familjes, të cilët/at përjetojnë dhunë, pra është e nevojshme forcimi i masave mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje, duke siguruar mekanizmin e lëshimit të Urdhrit të Masave Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, qëllimi i të cilit është parandalimi dhe zvogëlimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, si dhe të sigurojë më shumë mbrojtje për viktimat, ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitet 2018 (ligji 47/2018) dhe 2020 (Ligji 125/2020), duke përmbushur disa nga rekomandimet kyçe të Komitetit CEDAW (2016) dhe GREVIO (2017) për Shqipërinë. Këto ndryshime kanë zgjeruar dhe qartësuar përgjegjësitë e institucioneve në forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurat për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet.

Ndryshimet e vitit 2020⁴ kanë përmirësuar kuadrin ligjor në disa drejtime si: theksimi i vëmendjes së veçantë ndaj grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, urdhërimin nga gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë; shtimi i nenit për rehabilitimin e dhunuesve; përfshirja në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, të largimit të menjëhershëm të dhunuesit nga banesa, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes; aplikimi nga policia i kërkesës drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, nëse në vend është shpallur situatë e gjendjes së jashtëzakonshme, etj.

Me ndryshimet ligjore të kryera deri në vitin 2022, DHF dhe disa forma të DHBGJ-DHNGV (përdhunimi martesor, ngacmimi seksual, marrëdhëniet e dhunshme seksuale me të mitur, përndjekja, shkelja e urdhrit të mbrojtjes, trafikimi me të rritur dhe të mitur) janë përcaktuar si vepër penale dhe sanksione më të ashpra janë parashikuar kundër autorëve, si dhe janë përcaktuar kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas, duke përfshirë viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të ndjekjes penale.

Legjislacioni aktual për DHF/DHGV është i plotësuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në referim të Konventës së Stambollit dhe konventave të tjera të ratifikuara nga Parlamenti. Por kërkohet një Plan i veçantë gjithëpërfshirës i strukturave pjesëmarrëse në zinxhirin e MKR-së deri në rehabilitim, pasi konstatohet se legjislacioni për rehabilitim nuk është i plotë dhe për ato akte që citohet vendosja në përparësi e nevojave të viktimave (si strehimi, përkrahja ekonomike, apo largimi nga autorët e kryerjes së dhunës ,etj.,) ka mbetur më shumë në dëshirën e drejtuesve vendor, si institucioni që ngarkohet për zgjidhjen e problemeve sociale, por mungon vënia përpara përgjegjësisë me ligj për moszbatimin e këtyre detyrimeve.

Mbi monitorimin e SKBGJ viti 2021-2030

Strategjia kryesore që drejton veprimet për të arritur barazinë gjinore në Shqipëri është Strategjia e tretë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) dhe Plani i saj i Veprimit 2021-

2030, ku objektivi i saj i tretë strategjik synon reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Vizioni i SKBGJ është “Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e ri-integruar personat e dhunuar”.

Dokumente të tjera të rëndësishme të politikave që adresojnë barazinë gjinore dhe dhunën në familje janë: Plani Kombëtar i Veprimit për përfshirjen e burrave dhe djemve, si partnerë të grave dhe vajzave për barazi gjinore 2014 – 2019/21, Plani Kombëtar i Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020 dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2018-2020 për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Për Gratë, Paqen dhe Sigurinë”. Këto dokumente adresojnë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në plan kombëtar dhe vendor, si për masat parandaluese dhe masat e marra kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në zbatim të SKBGJ 2021-2030, MSHMS dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë strategji kombëtare kanë për detyrë që të kryejnë monitorim periodik me frekuencë gjashtë mujore, bazuar në informacionin që do të përcillet nga institucionet përkatëse përgjegjëse për zbatimin e masave dhe veprimeve të parashikuara në këtë strategji e shoqëruar me ekspertizë teknike të ofruar nga UN Women Shqipëri, por për arsye të kohës miratimit, për këtë vit është kryer për periudhën Qershor-Dhjetor 2021. Thëksojmë se të dhënat nuk janë marrë nga sistemi IPSIS¹², i cili do të ishte një regjistër i të gjithë treguesve që ka procesi deri në rehabilitimin e viktimave dhe krijonte ndjekje të vazhdueshme të ecurisë dhe efikasitet në kohë e shtrirje territori nga strukturat përgjegjëse. Ky sistem nuk është plotësuar këtë vit sipas detyrimit që ka MSHMS me arsyetimin se nuk është trajnuar akoma stafi i sektorit përkatës, arsyetim ky që nuk justifikon mos funksionimin e këtij sistemi të rëndësishëm.

Kjo nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015-2020¹³, si dhe me SKBGJ 2021-2030¹⁴, ku reflektohet lidhja e drejtpërdrejtë me plotësimin e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe të Axsendës 2030¹⁵.

Nga MSHMS në raportin e monitorimit është paraqitur një pasqyrim i zhvillimeve për periudhën vjetore 2021(sqarojmë se SKBGJ paraardhëse ka përfunduar në vitin 2020) me tregues të rëndësishëm në përparimin drejt barazisë gjinore si dhe në përpjekjet për adresimin në mënyrën e duhur të dhunës në familje e dhunës ndaj grave e vajzave në tërësi. Paralelisht me përmirësimin e kuadrit ligjor e të politikave janë ndërmarrë një sërë masash e veprimesh si një paketë e plotë me fokus rimëkëmbjen pas situatës së Covid-19, ku kuptohet gratë, të rejtat dhe vajzat ishin në qendër të vëmendjes, kjo dhe për faktin se gjatë kësaj periudhe treguesit e dhunës në familje e DHNGV kishin rritje të ndjeshme. Disa nga masat e marra kanë qenë: dyfishimi i masës së ndihmës ekonomike në para (të tilla si, dyfishimi e më pas trefishimi i mbështetjes ekonomike për rastet e dhunës në familje me urdhra mbrojtës, vendosjes në prioritet të grave kryefamiljare, etj.), funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara

¹² Pavarësisht përcaktimit në Strategji mbi mënyrën e monitorimit të zbatimit të saj, është e rëndësishme të theksohet që deri në momentin e përfundimit të këtij raporti monitorimi, të dhënat për SKBGJ 2021-2030 nuk janë hedhur në sistemin IPSIS dhe nuk është bërë trajnimi përkatës i stafit të strukturës përgjegjëse për barazinë gjinore në MSHMS, mbi mënyrën e përdorimit të këtij sistemi.

¹³ <https://elbasani.gov.al/sq-al/Documents/Strategjia%20Kombetare%20per%20Zhvillim%20Integrim%202015-2020.pdf>

¹⁴ <https://sdgs.un.org/goals>

¹⁵ <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>

për mbrojtje nga dhuna në familje e dhuna me bazë gjinore, si dhe me masa të tjera në drejtim të edukimit e fuqizimit ekonomik, etj. Është vlerësuar pozitiv dhe përdorimi i buxhetimit të përgjithshëm gjinor si praktikë përsheptuese për tejkalimin e pabarazisë, diskriminimit, dis-avantazhimit të dhunës, si në nivelin qendror, por edhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, sidomos në ato bashki që kanë përshtatur zbatimin e SKBGJ në planet vendore, duke i kthyer në dokumente praktikë dhe të zbatueshëm në punën e tyre të përditshme.

Është konstatuar nga monitorimi fakti që ky plan ende nuk është hedhur nga MSHMS në sistemin IPSIS, kjo ka ndikuar në mënyrën e raportimit nga të gjitha institucionet (bashkitë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit, SHSSH, etj), të cilat kanë dhënë më shumë një përshkrim të përgjithshëm të arritjeve që i konsiderojnë të rëndësishme për çështjet e fuqizimit të gruas dhe barazisë gjinore.

Ky informacion është i nevojshëm, pasi çështjet e barazisë gjinore janë ndër-sektoriale (cross-cutting) dhe si të tilla, ndikohen nga një tërësi hapash e veprimesh që hidhen në mënyrë të koordinuar apo edhe të pavarur nga tërësia e institucioneve publike e jo-publike qendrore e vendore, në çdo kohë. E rëndësishme është fakti i evidentimit dhe vënia e të dhënave në funksionimin e MKR-ve në të gjitha bashkitë në vend (61 bashki) si dhe vazhdimi i përgatitjes dhe shpërndarjes për miratimin nga Komitetet Drejtuese të Protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat/riturit në nivel vendor, përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar (prill 2021), trajnimi online i MKR-ve, i 40 koordinatorëve për sistemin REVALB dhe ngritja e kapaciteteve në MKR-të. Në gjashtë bashki në vend¹⁶ në vitin 2021, është punuar me modelin e ri- integritit social-ekonomik të viktimave të dhunës me bazë gjinore. Ky është një projekt i UN Women në bashkëpunim me organizatat “Të N..... dhe të B.....”(D&.....) dhe “Rrjetin S..... të F..... të G.....” (A.....).

Në monitorimin e SKBGJ-së është evidentuar dhe roli i institucioneve të pavarura sa i takon kuadrit ligjor dhe aksesit në drejtësi të grave. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), gjatë vitit 2021 ka ndërmarrë një sërë veprimesh sa i takon përmirësimit të kuadrit ligjor për çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, si rekomandime për Projektligjin “Për krijimin e regjistrit për autorët e krimeve seksuale”.

Një tjetër kufizim gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të SKBGJ 2021-2030, është dhe mungesa e informacionit mbi burimet financiare të vëna në dispozicion dhe të shpenzuara nga çdo institucion përgjegjës qendror apo i vetëqeverisjes vendore, përfshirë këtu dhe nga institucionet e pavarura, për të zbatuar masat dhe veprimet përkatëse dhe nuk është kryer matja e kosto-eficiencës në zbatimin e SKBGJ, për vitin 2021.

Nga monitorimi treguesit e vlerësimit të zbatimit aktivitetëve të parashikuara në SKBGJ 2021 – 2030 të SKBGJ, janë:

- 35% e aktivitetëve të parashikuara janë realizuar plotësisht;
- 21% e aktivitetëve janë realizuar pjesërisht;
- 14% e aktivitetëve janë në proces realizimi;
- 9% e aktivitetëve nuk janë realizuar;
- 21% të aktivitetëve nuk është dhënë informacion mbi statusin e realizimit, pra vlerësohet se kjo strategji ka gjetur zbatim dhe po merr vëmendjen e duhur, por kërkon një punë të shtuar për të rritur treguesit periodik të zbatimit.

Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore në nivel të vetëqeverisjes vendore janë zhvilluar në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore të miratuara nga këshillat bashkiake në pesë bashki në vend (Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Korçë), por siç konstatohet numri i kufizuar i njësive vendore tregon se në nivel vendor trajtimi i çështjeve të DHNGV dhe DHF është i pamjaftueshëm dhe me një ndikim negativ në jetën sociale. Ka një mungesë strategjie apo plan veprimi për problemet e dhunës në familje, por

¹⁶ Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër dhe Pogradec

duke u mjaftuar veç me trajtimin e rasteve të dhunës kundër grave që ndodhin në territorin e tyre, pra nuk ka një plan veprimi vendor me bazë risku si për masat parandaluese dhe të ndërgjegjësimit, por dhe në ndjekjen e problemeve që në lindjen e tyre, duke u bazuar në riskun që ka zona bazuar në traditën patriarkale të familjes, niveli arsimor i ulët, gjendja ekonomike, etj.

Masat parandaluese dhe ndërgjegjësuere të marra për dhunën në familje (DHF) dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave (DHNGV).

Nga MSHMS trajtimi i parandalimit të dhunës është vlerësuar si një çështje që kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të MKR si Ministrinë, pushteti vendor, OJF/shoqëria civile dhe media, etj.

Në aktivitetin dhe përgjegjësitë e MSHMS, parandalimi i dhunës përfshin:

1- Hartimi dhe Miratimi i kuadrit ligjor në mbrojtje të grave dhe vajzave nga dhuna në familje(trajtuar nga ana jonë në pikën e mësipërme të këtij Raporti Auditimi)

2- Zhvillimit të fushatave të ndërgjegjësimit për eliminimin e stereotipave gjinore, diskriminimit në fusha të ndryshme, promovimit të barazisë gjinore dhe modeleve pozitive, organizimit të fushatës së përvitshme të ndërgjegjësimit të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave 25 Nëntor - 10 Dhjetor.

3-Fuqizimit të grave.

4-Fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve (anëtarë të MKR-ve).

Për sa është referuar në informacionin e paraqitur nga MSHMS për pyetjen e bërë nga grupi i auditimit vlerësohet se janë referuar vetëm masave të parashikuara në SKBGJ 2021-2030.

Pyetjes së bërë Drejtorisë së Përgjithshme të Barazisë Gjinore: *“Si kryhet parandalimi i dhunës në familje? A ka fonde të dedikuara për këtë qëllim dhe sa janë ato sipas periudhave ?”* nuk morëm përgjigje të plotë dhe nuk është bërë një pasqyrë e aktiviteteve që kanë iniciuar dhe kanë kryer, si dhe nuk na janë vënë në dispozicion marrëveshje për këto aktivitete sensibilizimi dhe ndërgjegjësi.

MSHMS, çdo vit ka vijuar zhvillimin e fushatës ndërgjegjësuere të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave nën fushatën globale UNITE nga **25 Nëntor- 10 Dhjetor 2021** nën sloganin *“Të ndalim dhunën ndaj grave tani”*. Mbi 300 aktivitete ndërgjegjësuere janë zhvilluar vetëm gjatë 16 ditëve të aktivizimit, me pjesëmarrjen e institucioneve, bashkive, organizatave të shoqërisë civile, partnerë vendorë, veçanërisht mbështetur nga organizatat e UN, në institucionet arsimore të 52 ZVAP-ve, shkollat, etj. edhe në Arsimin e mesëm dhe të ulët (AMU) me fokus barazinë gjinore dhe ndër të tjera nxënësit kanë performuar në fusha të ndryshme si piktura, kërcimi, teatri dhe letërsia, duke dhënë mesazhe sensibilizuese kundër DHBGJ. Po kështu dhe në vitin 2022 janë zhvilluar aktivitete sensibilizues e ndërgjegjësuere me të njëjtin ritëm, ku siç e theksuam, nuk mjaftojnë vetëm 15 ditë në vit, por fushatat sensibilizuese duhet të jenë në vazhdimësi.

Drejtoria e Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, për periudhën 30 mujore (Janar 2021-Qershor 2023), nga 425 aktivitete që ka kryer gjithsej, janë organizuar 29 takime e aktivitete me fokus Dhunën ndaj Grave e Vajzave dhe parandalimin e saj. Në vlerësimin dhe verifikimin e aktiviteteve ky institucion ka kryer një numër të konsiderueshëm aktiviteteve ku i bie në çdo dy ditë është kryer një aktivitet. Evidentohet larmia e takimeve ku bie në sy që përveç trajtimit të shqetësimeve tjera (këtu nuk përjashtohen diskutimet për rëndësinë ligjore të trajtimit të dhunës në barazinë gjinore, por edhe tema të veçanta).

Siç konstatohet nga pasqyra e aktiviteteve, rezulton se nga kjo Drejtori ka një punë të organizuar në drejtim të zhvillimit të aktiviteteve si informuese, por dhe në aktivitete që kanë dhe impakt sensibilizimi me pasojat që sjell dhuna në familje dhe veçanërisht dhuna me drejtim

gjinor. Fakt tjetër del se ka patur një gjithë përfshirje si të organizatave të ndryshme (OJF), por dhe të pushtetit vendor (Punonjës që janë pjesë e MKR dhe ato social për shtresat e tjera, siç janë takimet në Bashkitë Fier, Tiranë, Elbasan Kavajë Lushnje, Kamzë, Patos, Dropull, Durrës e Pogradec. Vlerësohen dhe takimet sensibilizuese dhe edukuese të bëra në ambientet e shkollave të ndryshme 9 vjeçare dhe të mesme si në shkollat: “Kostandin Kristoforidhi” Elbasan, Dropull, shkollat "9-vjeçare", SHMB Bularat dhe Dervician Aktivitet pranë Qendrës Rinore Berat, (Takim me nxënësit e shkollave të mesme.), etj. si dhe në ambientet e disa Fasonerive (ku 97% e punonjësve janë gra dhe vajza, ku nga informacionet e mara paraprakisht se në këtë ambient pune ka punonjëse që janë me urdhër mbrojtje) në kuadër të kategorisë së veçantë. Po kështu janë zhvilluar aktivitete dhe në bashkëpunim me Drejtoritë Vendore të Policisë Durrës, Fier dhe në të shumtën e rasteve janë ftuar dhe punonjësit e sigurisë në shkolla dhe psikologët.

Megjithëse, nga kjo Ministri (drejtoria përkatëse e DNJF), është kryer punë, vlen për t’u theksuar se në aktivitetet e saj duhet një vëmendje e veçantë në drejtim të sensibilizimit të shtresave që janë vulnerabël ndaj DHNGV, me qëllim parandalimin e saj si një plagë e rëndë e shoqërisë tonë, duke evidentuar si ndihmën juridike për njohjen e kësaj dhune në format e shfaqjes së saj në familje e kudo, por edhe njohjen me pasojat juridike dhe sociale që do kenë veprimet e dhunuesve përballë ligjit.

Në seksionin “Shtojca”, kemi të ilustruar me foto dhe aktivitete të kryera nga Ministria e Drejtësisë (DNJF), ku konstatohet se kanë marrë pjesë dhe nga komunitetet fetare, pra kemi një angazhim në parandalimin e të gjithë faktorëve të shoqërisë tonë.

Janë kryer edhe fushatat e avokimit dhe ndërgjegjësimit të organizuara së bashku nga anëtarët e MKR-ve në nivel qendror e vendor në shkolla ose me anëtarë të komunitetit përfshirë edhe Njësitë administrative vendore, duke i afruar anëtarët e MKR-ve me komunitetin dhe ka rritur njohjen, aksesin dhe praninë e tyre në terren.

<i>Parandalimi i dhunës në familje ka kosto më të ulët se menaxhimi i rasteve të dhunës në familje.</i>

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, ka rëndësi themelore, pasi ato mund të ndikojnë ndjeshëm në ndërgjegjësimin rreth barazisë gjinore, drejtësisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe ofrimin e ekspertizës për zhvillimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara në mbrojtje, trajtim, rehabilitim e ri integrim të viktimave/të mbijetuarave, apo dhe programeve të rehabilitimit të dhunuesve. Siç është evidentuar në vendin tonë ka një numër të madh OJF të shoqërisë civile dhe impakti i tyre social dhe ekonomik është i konsiderueshëm në fazat e momentit pas referimit të dhunës e deri në rehabilitim, por kanë munguar fushata të ndjeshme për parandalimin, këto kanë mbetur vetëm në fushata të ditës ndërkombëtare kundra dhunës 25 Nëntori, por siç e kemi sqaruar mungojnë të dhëna statistikore nga këto OJF.

Përveç fushatave, aktivitetet ndërgjegjësuere janë fokusuar edhe tek edukimi i grave për të drejtat e tyre dhe rritja e kualifikimeve të ofruesve të shërbimeve dhe punonjësve të drejtësisë për të kuptuar dhe reaguar ndaj DHNGV-së. Për shembull, MSHMS dhe ministritë e tjera të linjës dhe institucionet e tjera të varësisë kanë organizuar aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve për DHNGV-së (p.sh., policë, mjekë, infermierë, punonjës socialë, profesionistë të drejtësisë dhe mësues). Por vështirësia e hasur është se burimi kryesor i financimit të aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve janë donatorët ndërkombëtarë, për të cilat nuk ka të dhëna të konsoliduara.

Ky fenomen është konstatuar nga grupi i auditimit dhe në trajtimin e peshës në buxhet të barazisë gjinore e DHNGV, ku nuk ka asnjë institucion që të ketë programim e zbatim të buxhetit në mënyrë analitike për fondet që nevojiten e përdoren për fushata sensibilizuese e ndërgjegjësuere, për masat që duhet merren për parandalimin e e dhunës ndaj grave e vajzave. Jo gjithmonë këto fushata apo aktivitete e kanë arritur qëllimin, pasi mungesa e buxhetimit të tyre, duke sjellë dhe mos plotësimin e programeve të tyre dhe shtrirjen në hapësira më të mëdha e kryesisht në zona më të largëta e me problematika më të mëdha për shkak të stereotipave dhe traditave patriarkale që sjellim dhunë në familje e grave dhe vajzave, e justifikuar se: *“nuk kemi fonde, nuk na financon shteti...vetëm donatorët dhe ato i kanë procedurat e ngarkuara dhe me shtrirje në kohë...etj.”*

Organizimi sistematik i fushatave të avokimit dhe ndërgjegjësimin për vitet 2019-2020 dhe periudhën e auditimit 2021-2022, ka sjellë frytet e tij, pasi është rritur numri i rasteve të raportuara të DHF çdo vit (10-13%).

Referuar treguesit zyrtar të mësipërm, efektet e fushatave sensibilizuese e ndërgjegjësuere kanë dhënë efekte pozitive, pasi shoqëria është ndërgjegjësuere për ta bërë prezent dhunën në familje e atë me barazi gjinore, kjo sjell detyrimin e institucioneve të MKR dhe të drejtësisë, që të përdorin instrumentet e tyre për ndëshkimin e dhunuesve dhe rehabilitimin e të dhunuarve si pjesë e shoqërisë sonë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si një ndër institucionet kryesore përgjegjëse dhe pjesë e Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të DHF, për periudhën e auditimit ka kryer fushata sensibilizuese për dhunën me bazë gjinore dhe dhunës në familje, konkretisht:

Në vitin 2021 në kuadër të fushatës së përvitshme “16 ditët e Aktivizimit të Dhunës me Bazë Gjinore” (25 Nentor-10 Dhjetor 2021) i është bashkuar aktiviteteve të kryera nga MSHMS dhe organizatat e ndryshme që veprojnë në këtë fushë, duke nxjerrë Urdhër për zbatim në të gjitha Drejtoritë Vendore me temë : “Bëje botën portokalli, Të ndalim dhunën ndaj grave TANI!” etj. Po kështu ka zgjeruar aktivitetin nëpërmjet Programit për Forcimit e Policimit në Komunitet, SCPA dhe Pushtetit vendor dhe ka kryer aktivitete në DV Elbasan, Kukës, Tiranë dhe Komisariatit e Policisë Pogradec. Mesazhet e dhëna kanë qenë:

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është krim dhe e dënueshme;

Rritjen e njohurive të punonjësve të policisë në këtë proces;

Informacione të sakta për publikun, se ku mund të drejtohen dhe çfarë duhet të bëjnë në rastet e dhunës, etj.

Në programet e policimit në komunitet janë përdorur fletë palosje, postera në vende të dukshme dhe në komisariatet e Policisë ka pankartën “Raporto dhunën ndaj grave”. Njëkohësisht kanë marrë pjesë punonjës e përfaqësues të sektorëve të dhunës ndaj grave në media kombëtare dhe lokale.

Me të njëjtin format është punuar gjatë vitit 2022, duke qenë pjesë e fushatës 16 ditore të ditës kundra dhunës në familje e me bazë gjinore. Kanë zhvilluar takime sensibilizuese në bashkëpunim me koordinatorët vendorë në bashki dhe në shkollat e mesme publike duke kërkuar parandalimin dhe shpjeguar format e mbështetjes së grave që dhunohen, etj.

Figura nr. 5



Siç konstatohet, në strukturat e policisë megjithëse punohet me bazë risku, por për efekte dhe ngarkesës që kanë punonjësit e policisë është e nevojshme që fushatat të kryhen me bazë risku dhe në ato zona ku krimi i dhunës në familje ka tendencë rritje dhe mungojnë aktivitetet e institucioneve të tjera dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe vetë punonjësit e policisë nuk janë të trajnuar plotësisht për arsye të ndryshme siç janë zonat e largëta malore, ku dhe patriakalizmi në familje ka ndikim jo të vogël, etj. Aktivitetet ndërgjegjëse kundër dhunës me bazë gjinore duhet të organizohen vazhdimisht dhe të mos kufizohen vetëm gjatë fushatave specifike, si fushata ndërkombëtare e “16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”.

Në seksionin “Shtojca” më poshtë, ilustrohen disa aktivitete të zhvilluara nga DSHS Durrës, ku ka një gjithë përfshirje dhe pjesëmarrje dhe të përfaqësuesve të Policisë së Shtetit:

1- Gjetje nga auditimi: Legjislacioni ka patur mangësi në evidentimin e përgjegjësive të personave që janë pjesë e sistemit të MKR-së për masat parandaluese, por edhe për drejtuesit e pushtetit vendor që nuk përmbushin detyrimet ligjore për rehabilitim e viktimave të dhunës në familje si pjesë e mbrojtjes që parashikohet. Ka munguar gjithashtu bashkëpunimi ndër institucional i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Brendshme dhe/ose Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të evidentuar dhe marrë masat e nevojshme për sensibilizuese të cilat kanë impakt të lartë social.

1. Konkluzioni: Drejtuesit vendorë në shumë NJVQV (Bashkitë e vogla) dhunën ndaj grave e vajzave e kanë trajtuar si problem të dorës së dytë. Mungesa e fushatave sensibilizuese e ndërgjegjëse ka ndikim negativ në komunitetin e këtyre njësive vendore.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa për të propozuar ndryshime ligjore ku të kërkohet ashpërsimi i legjislacionit, për vënien përpara përgjegjësisë administrative dhe penale të përfaqësuesve të institucioneve qendrore e vendore, që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar dëmtime të rënda në marrëdhëniet familjare ose viktimat.

Brenda datës 30.06.2024

2- Gjetje nga auditimi: Bazuar në treguesit e evidentuara konstatohet se në përmbushje të trajtimit sa më të efektshëm të çështjeve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave në nivel vendor (bashkitë/njësitë e vetëqeverisjes vendore), konstatohet se vetëm 5 Bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Korçë), kanë hartuar Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave, ndërsa bashkitë e tjera nuk kanë një Plan veprimi vendor për çdo bashki dhe shtrirjen e tyre në plan veprimi për ato Njësi Administrative që janë me risk të lartë në mungesën e barazisë gjinore të ndikuar nga faktorë të ndryshëm territorial (Njësi administrative/Qark). Mungesa e këtyre Planeve veprimi vendore nuk përkon me detyrimin që kanë këto njësi vendore në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016-2020”, miratuar me VKM nr. 73, datë 20.10.2016 dhe Objektivin 3.1 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” dhe Objektivi 4.4 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për pranimin e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit”; dhe kërkesat e Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2021-2030” miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021.

2. Konkluzioni: Mungesa e një plan veprimi vendor në rang Bashki/Njësie administrative apo Qarku, ndikon në ndjekjen e problemeve të dhunës ndaj grave në familje, si dhe mungesë përgjegjësie të njërive vendore për mbrojtjen e tyre. Mungesa gjithashtu sjell shmangie nga detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i strategjive kombëtare “Për Barazinë Gjinore” dhe të Planit të Veprimit 2016-2020/30”.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të marrin masa, për të kërkuar nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashki/Qark dhe Njësitë Administrative) përgatitjen dhe miratimin në Këshillin Bashkiak/Qark të Planit të Veprimit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave, duke përcaktuar sa më qartë hapat, strukturat e përfshira, fushat e bashkëpunimit me institucione shtetërore dhe organizata joqeveritare, institucionet vendore të arsimit etj., të përfshira në zinxhirin e ngritur nga momenti i referimit deri në zgjidhjen e problemit paraqitur si dhe të evidentohet qartë veprimtaria ndërgjegjësuëse e parandaluëse në këtë drejtim.

Brenda datës 30.06.2024

3- Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur u konstatua se, mungon një plan buxhetimi në tërësi dhe në mënyrë analitike lidhur me fushatat sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse për parandalimin e dhunës ndaj grave e vajzave, në institucionet qendrore (MSHMS, MAS, MB e MD) dhe ato vendore ku përmendim drejtoritë rajonale në qarqe dhe zyrat e shërbimit social në bashki. Evidentohet, mos konsolidim i buxheteve për barazinë gjinore në këto institucione dhe mungesë bashkëpunimi me shoqatat e organizatat e shoqërisë civile, në funksion të financimit dhe ndjekjes së përdorimit të fondeve sipas kërkesave të ligjit për buxhetin dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Ka munguar financimi për organizatat e shoqërisë civile, si një faktor me ndikim të rëndësishëm, në kryerjen e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse për parandalimin e dhunës në familje. Nuk është siguruar një shpërndarje e drejtë e aktiviteteve në zonat e vendit sipas hartës së DHF e DHNGV, pasi shoqatat janë më të përqendruara në Tiranë, Durrës e qytete të tjera të mëdha, çka ka lënë jashtë vëmendjes qytetet e vogla dhe zonat e largëta rurale.

3. Konkluzioni: Mungesa e planeve të buxhetimit për kryerjen e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse nga institucionet përkatëse për parandalimin e Dhunës në familje e dhunës ndaj grave e vajzave dhe mungesa e financimeve për shtrirjen e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse në territor ndikon negativisht për parandalimin e dhunës në familje.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e autoritetit kryesor përgjegjës, të kërkojë nga institucionet e tjera që ngarkohen me ligj, pjesë të zinxhirit të trajtimit të viktimave të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare si dhe detyrimeve ligjore për marrjen e masave parandaluese, të marrin masa për të rritur buxhetet për barazinë gjinore sa i përket parandalimit dhe të bëjnë programimin dhe zbatimin analitik të fondeve.

Në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, të marrin masa të organizojnë trajnime të mirë përcaktuara për çështjet e dhunës me bazë gjinore për punonjës të shëndetit, punonjës socialë, juristë dhe profesionistë të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, stafit mjekësor, dhe OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

Në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Nga strukturat e Policisë së Shtetit nuk është punuar vazhdimisht me bazë risku. Nuk ka programe të veçanta të miratuara për fushata parandaluese apo aktivitete të ndryshme ndërgjegjësimi në komunitet. Mungojnë trajnimet e dedikuara për punonjësit që punojnë në zonat me risk të lartë për krime dhune ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje, çka ndikon si në aspektin e mos deklarimit të rasteve nga viktimat, por edhe në mos ndjekjen e problemeve për mbrojtjen e viktimave të dhunës si dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të dhunuesit.

4. Konkluzioni: Mungesa e veprimtarisë me bazë risku e strukturave të policisë, mos marrja e masave parandaluese e ndërgjegjësuere si dhe mos mbulimi i të gjitha zonave të largëta me shërbim të plotë policor, ka ndikim në përgjigjen në kohë dhe me profesionalizëm ndaj këtij fenomeni.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet strukturave përkatëse të hartojë programe të veçanta dhe të marrë masa për përcaktimin e zonave apo territoreve që kanë risk të lartë krimi të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave e vajzave, si dhe të organizojë përsheptimin e programeve trajnuese mbi zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.

Në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe bashkitë në vend, të kryejnë fushata ndërgjegjësimi me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave policore e atyre vendore veçanërisht në zonat e largëta të cilat kanë mungesë të shërbimeve lokale, për të qenë sa më afër viktimave të dhunës, mbështetjen e menjëhershme psiko - sociale e ligjore, si dhe shmangien e veprimeve që mund të sjellin stigmatizimin e denoncueseve të dhunës.

Në vijimësi

5.2 Pyetje e auditimit: A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?

Sistemi i mbrojtjes ndaj dhunës në familje, përfshirë dhe gratë dhe fëmijët të cilët janë në situatë dhune në marrëdhëniet familjare rregullohet sipas ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet

familjare¹⁷. Ky ligj ka si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, nëpërmjet krijimit të një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje.

Institucionet e përfshira në këtë rrjet janë institucione qendrore dhe vendore, sipas kompetencave dhe fushëveprimit të aktiviteteve të tyre. Nga këto veçojmë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti përgjegjës për zhvillimin e politikave për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Janë pjesë e rrjetit edhe autoritete të tjera përgjegjëse të linjës si: ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike e cila përfshihet në këtë kuadër nëpërmjet strukturave të Policisë së Shtetit; si dhe ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë e cila ofron mbështetje nëpërmjet ndihmës juridike falas.

Peshën më të rëndësishme në trajtimin e rasteve të dhunës në familje e mbajnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku edhe është krijuar Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje i cili ka funksionuar që prej vitit 2011¹⁸. Ky mekanizëm është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.¹⁹ Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; ekipet teknike ndërdisiplinore (ETN); koordinatorët vendorë (KVDH). Këto tre figura dhe ndërveprimet midis tyre kryejnë menaxhimin e drejtpërdrejtë të rasteve të dhunës në familje në vendin tonë.

Vlen të theksohet se dhuna në familje, sidomos kundrejt grave, është shndërruar tashmë në një problem të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare, numri total i rasteve të dhunës në familje për periudhën 2019 – 6 muajori 2023 është 22,246 (mesatarisht 4964 raste në vit për katër vitet 2019 – 2022), ku viti 2021 ka qenë viti i cili ka shënuar numrin më të lartë të rasteve me 5312 të tilla²⁰.

Tabela nr. 6 Numri i rasteve të dhunës në vendin tonë

Viti	Raste dhune në familje evidentuar gjithsej	Nr. rastesh që kanë marrë UMPMM	K. Padi për UMM/UM	Procedime neni 130/a Kodi Penal	Arrestuar për 130/a	Vrasje raste/viktima në marrëdhëniet familjare
2019	4629		2836	1341	535	14/17
2020	4701	276	2816	1505	615	6/7
2021	5312	415	3266	1631	638	16/16
2022	5214	357	2940	1887	683	10/12
6 Muajori 2023	2390	235	1308	896	315	7/9

Burimi: DPPSH


Grafik nr. 1 Numër rastesh në total

¹⁷ Ligji nr. 9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

¹⁸ Neni 3, pika 5, i Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.


¹⁹ VKM nr. 327, datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

²⁰ Të dhëna zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.



Në nivel qarku, numrin më të lartë të rasteve e raporton Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me mesatarisht rreth 1600 raste në vit, ndjekur nga DVP Durrës me rreth 754 raste në vit. Numrin më të ulët të rasteve e raporton DVP Kukës (mesatarisht rreth 50 raste në vit) dhe DVP Gjirokastrë me rreth 95 raste në vit.

Grafik nr. 2 Rastet sipas Qarqeve



Duhet theksuar se në vendin tonë shumica e personave të dhunuar janë femra, shpeshherë të shoqëruara me fëmijë, duke evidentuar se dhuna në marrëdhëniet familjare bashkëshortore është një plagë tashmë e thellë e shoqërisë shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Shtetit paraqitura në tabelën më poshtë, rreth 74% e të dhunuarve i përkasin gjinisë femërore.

Tabela nr.7 Numër rastesh sipas gjinisë

Viti	Raste dhune në familje evidentuar gjithsej	Nr. Rastesh i dhunuari gjinia femër	Nr. Rastesh i dhunuari gjinia mashkull	% i dhunuesi gjinia femër	% i dhunuar gjinia mashkull
2019	4629	3596	1235	78%	27%
2020	4701	3497	1370	74%	29%
2021	5312	3871	1458	73%	27%
2022	5214	3772	1466	72%	28%
6 Muji 2023	2390	1759	697	74%	29%

Burimi: DPPSH

Trendi në përqindje i të dhunuarve të gjinisë mashkullore vitet e fundit duket në rritje, çka sugjeron edhe se dhuna me bazë gjinore në shoqëri nuk kursen askënd.

Sipas raporteve të shumta të publikuara edhe nga OJF aktive në fushën e dhunës me bazë gjinore në vendin tonë, arsyet kryesore që nxisin këtë fenomen janë kryesisht problemet ekonomike shoqëruar me mentalitetin patriarkal dhe nivelin e ulët arsimor të individëve të përfshirë në marrëdhënien e dhunës qofshin ata të dhunuar apo edhe dhunues.

Sipas studimit për hartëzimin e shërbimeve²¹, mekanizmi i koordinuar i referimit është krijuar në 44 bashki, katër bashki më shumë se në vitin 2019, ku rezultoi 40 MKR të krijuar sipas Analizës së Funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri²². Ndërsa në çdo bashki të vendit aktualisht ka të paktën 1 koordinator vendor për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, me përjashtim të bashkive Fier dhe Durrës të cilat kanë 2 KVDH. Pra në total në vendin tonë ka 63 KVDH për 61 bashkitë e vendit.

MKR është ngritur në nivel vendor për të menaxhuar nevojat emergjente të rasteve të dhunës në familje, si edhe për të gjetur zgjidhje afatgjatë për të dhunuarit dhe dhunuesit me qëllim fuqizimin e viktimës së dhunës, rehabilitimin e dhunuesit dhe fuqizimin e familjes për të shmangur në të ardhmen përsëritjen e këtyre rasteve.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion²³ aktualisht në vendin tonë parashikohet ofrimi i 8 tipologjive të ndryshme të shërbimeve: parashoqërore, rezidenciale, komunitare, në familje, të specializuara, këshillim, emergjencë, kujdes alternativ.

Nga këto 8 tipologji shërbimesh, për viktimat e dhunës (gratë e dhunuara) ofrohen vetëm 4 tipologji shërbimesh në 12 bashki të vendit, 1 në Këshillin e Qarkut Tiranë, plus një shërbim rezidencial kombëtar në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Këto katër shërbime janë të tipit rezidenciale, komunitare, këshillim, emergjencë. Më konkretisht këto paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 8 Llojet e Shërbimeve

Nr.	Niveli i qeverisjes/Shërbimet	Rezidenciale	Komunitare	Këshillim	Emergjencë
A.	Nivel Kombëtar	Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje (P)			
B.	Nivel NJVQV				
1	Tiranë	Strehëza për Gratë dhe Vajza "E..... H....." (OJF)	Qendra për zhvillim komunitar "Sot " (OJF)	L..... e K..... Për G..... dhe V..... (P/OJF)	Qendra për zhvillim komunitar "Sot për të ardhmen" (P)
2	Vau i Dejës	Qendra e Gruas "H.. të L..... " (OJF)			
3	Elbasan			Forumi i g.....E.....-S..... (OJF)	Forumi i Gruas Elbasan - Qendra e Emergjencës (P)
4	Kukës				Strehëza e emergjencës për gratë e dhunuara nga zonat rurale (P)
5	Dibër			Organizata Vatra (P)	

²¹ Draft Hartëzimi i Shërbimeve version datë 30 qershor 2023.

²² Analiza e Funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri, fq. 9 https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/web_MKR.pdf

²³ Të dhëna zyrtare të vendosura në dispozicion nga Shërbimi Social Shtetëror.

6	Korçë				Q. Emergjente dhunës(P)
7	Berat	Strehëza për gra dhe vajza të dhunuara dhe fëmijë në situatë rrugë(P)			
8	Roskovec				Strehëza "Gratë e Dhunuara"(P)
9	Divjakë			Gra dhe f..... në f.....(shërbime psikologjike)(OJF)	
10	Sarandë				Qendra e Emergjencës për viktimat e dhunës(P)
11	Vlorë			K..... L..... në Mbështetje të Viktimave të Dhunës.(OJF)	
12	Lushnjë				Shë.....e v.... të z..... (viktima të dhunës në familje)(OJF)
13	Gjirokastrë				Qendër multifunkionale/Qendër emergjencash (P)
Total		3	1	5	8

Burimi: SHSSH

Në total në vendin tonë ofrohen 19 shërbime, nga këto:

- ✓ 10 janë shërbime që ofrohen nga shteti: 2 shërbime rezidenciale (1 shërbim rezidencial kombëtar dhe 1 shërbim rezidencial në Bashkinë Berat), 7 shërbime emergjence në Bashkitë Tiranë, Elbasan, Kukës, Korçë, Roskovec, Sarandë, Lushnjë dhe Gjirokastrë;
- ✓ 7 shërbime ofrohen nga OJF (2 shërbime rezidenciale në Bashkitë Tiranë dhe Vau i Dejës, 1 shërbim komunitar në Bashkinë Tiranë, 3 shërbime këshillimi në Bashkitë Elbasan, Divjakë dhe Vlorë, 1 shërbim emergjence në Bashkinë Lushnjë);
- ✓ 1 shërbim miks këshillimi (bashkëpunim pushtet vendor OJF) në Këshillin e Qarkut Tiranë.

Numri total i përfituesve nga këto shërbime është 903, nga këto 108 janë përfituese që marrin shërbime publike dhe 795 marrin shërbime jo - publike.

5.2.1 Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira?

Në Strategjinë për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (më tej SKBGJ) dhe Planin e veprimit të saj²⁴ parashikohet, ndër të tjera, qëllimi strategjik nr. 3 për zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ku MSHMS ka një rol të rëndësishëm së bashku me institucione të tjera qendrore dhe vendore.

Në këtë drejtim MSHMS është angazhuar, si në rolin e institucionit përgjegjës, ashtu edhe në rolin e institucionit partner, sa i takon trajnimit të stafëve të ndryshme të angazhuara në këtë fushë. Në veçanti, në rolin e institucionit përgjegjës është angazhuar gjerësisht në trajnimin e anëtarëve të MKR – së për të gjitha aspektet që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre në nivel vendor. Pavarësisht këtij angazhimi ka disa fusha ku veprimtaria e institucionit ka mangësi.

Më konkretisht sa i takon fuqizimit të sistemit REVALB dhe përdoruesve të tij, si dhe kalimit të tij në një bazë të dhënash shtetërore, tërësisht në menaxhim nga autoriteti kryesor përgjegjës duke e lidhur edhe me sisteme të tjera relevante të mbledhjes së të dhënave, ende ky institucion nuk është angazhuar në përsheptimin e këtij procesi, sidomos për lidhjen e tij me sisteme të tjera të rëndësishme në këtë fushë siç është SSHKSH (Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit

²⁴ VKM nr. 400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Barazisë Gjinore 2021 – 2030 dhe Planit të Veprimit të saj.

Shoqëror). Aktualisht, këto dy sisteme nuk ndër veprojnë me njëri tjetrin dhe plotësimi e menaxhimi i tyre nga KVDH është i vështirë për shkak të problemeve teknike të tyre si dhe për arsye se ka dublim të punës për KVDH – në (për një rast duhet të plotësojë REVALB – in dhe SSHKSH).

Ndryshimet e bëra në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare në vitin 2020²⁵ sollën përmirësime të rëndësishme sa i takon, detyrimit për largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga banesa (nëpërmjet UMPMM nga Policia e Shtetit, apo nëpërmjet UMM/UM të lëshuar nga Gjykata për atë afat kohor që përcaktohet në këto urdhra), si dhe programeve specifike të rehabilitimit për dhunuesit. Në SKBGJ në objektivin specifik III. 1 parashikohet që të gjithë llojet e programeve rehabilituese për dhunuesit të shtrihen në të 12 qarqet e vendit (të paktën 1 shërbim çdo 2 vjet, 6 shërbime të ngritura në vitin 2025) duke krijuar kështu mundësitë për rehabilitimin e dhunuesve, bazuar në standardet e Konventës së Stambollit dhe modelet pozitive ndërkombëtare.

Sikurse mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 8 më sipër aktualisht ende nuk ka asnjë shërbim të ngritur për strehimin/rehabilitimin e dhunuesit në momentin kur urdhërohet largimi i menjëhershëm nga banesa. Në raportin e monitorimit të SKBGJ për vitin 2022 ky aktivitet raportohet në proces, duke qenë se shtrirja e tij është parashikuar deri në 2025, MSHMS ka filluar me hartimin e planit për pilotimin e programeve kombëtare rehabilituese, por ende nuk ka nisur pilotimi i këtyre shërbimeve. Duhet theksuar se në nivel kombëtar (shtet e shoqëri civile), përveç fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi tematikat e dhunës në familje, nuk ka angazhim të qenësishëm në këtë drejtim, duke konsideruar se çrrënjësja e këtij fenomeni kalon jo vetëm nëpërmjet ndëshkimit të dhunuesit, por edhe nëpërmjet rehabilitimi dhe propozimit të modeleve alternative të sjellëve për shmangien e konflikteve në marrëdhëniet familjare.

Në rolin e vet si institucion politik bërës, vëzhgues e monitorues të mekanizmit të ngritur (nëpërmjet institucioneve përkatëse të varësisë) për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje me të gjitha nuancat institucionale e shoqërore që mbartin këto, vërehet se ky institucion nuk arrin të kryejë analiza të thella dhe domethënëse për situatën aktuale të këtij mekanizmi dhe shërbimeve që janë mundësuar në nivel kombëtar dhe lokal për përballimin e kësaj patologjie sociale. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore në MSHMS nuk analizohen në detaje shkaqet e mungesës së shërbimeve, mungesës së kapaciteteve strehuese dhe financiare, mungesës së ndërveprimit dhe vullnetit për angazhim serioz nga të gjithë institucionet. Në këtë organ, diskutohet në parim për arritjet dhe miratohen raporte monitorimi, por nuk diskutohet gjerësisht e konkretisht për dështimet, sfidat dhe nevojat.

Ka munguar ndërveprimi dhe komunikimi i duhur zyrtar midis anëtarëve të ETN - së që trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe KVDH - vë në bashki.

Sipas bazës ligjore aktualisht në fuqi²⁶, referimi i rastit të dhunës në familje mund të kryhet nga çdo institucion anëtar i ETN – së, apo persona të tjerë privatë apo juridikë, si dhe nga njoftime në median e shkruar apo sociale.

Përgjithësisht, Policia e Shtetit është institucioni i parë me të cilin përballen viktimat e dhunës në familje, pasi kontakti dhe referimi i rastit në organet e tjera në nivel vendor (KVDH, ETN e më tej) kalon nëpërmjet tij. Në vijim të referimit të rastit nga policia, KVDH bën raportimin, identifikimin dhe menaxhimin e tij në vijim nëpërmjet ndërthurjes me ETN.

25 Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

26 VKM nr. 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

Raporti i vlerësimit të riskut është një dokument në të cilin punonjësi i policisë përshkruan ngjarjen duke marrë informacion nga i dhunuari, dhunuesi dhe ose dëshmitarë të tjerë. Në momentin e paraqitjes së rastit punonjësi i policisë, sipas rregullave, njofton menjëherë KVDH për paraqitjen e rastit. Ai mund të njoftojë psikologun e DVP – së nëse rasti shoqërohet edhe me fëmijë. Mungesa e KVDH – së nuk përbën pengesë për hartimin e raportit të vlerësimit të riskut nga ana e punonjësit të policisë.

Në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje²⁷ thuhet se një kopje e raportit të vlerësimit të riskut i njoftohet menjëherë titullarit të strukturës përgjegjëse (policisë) dhe punonjësve (kryesisht KVDH) që thirren për hartimin e këtij raporti.

Pavarësisht kësaj, në zbatim nuk garantohej rrjedhshmëri informacioni e mjaftueshme midis strukturave vendore të policisë dhe KVDH – së, për aq kohë sa ky i fundit nuk është i detyruar të jetë prezent në çdo rast kur kryhet vlerësimi i riskut për rastet e dhunës. Po kështu nuk garantohej gjurmueshmëria e dokumentacionit për të verifikuar në çdo rast punën e strukturave të policisë dhe bashkëpunimin e tyre me KVDH në fazat e para të trajtimit të rastit.

Mungesa e dokumentacionit është konstatuar edhe gjatë vëzhgimeve në terren në DVP Kukës, Durrës dhe Gjirokastrë, nga ku rezulton se nuk i kushtohet vëmendje e veçantë ruajtjes së një kopjeje të praktikës (duke nisur nga raporti i vlerësimit të të riskut e të tjerë), e cila në shumicën e rasteve përcillet në organet përkatëse të gjyqësorit për vlerësime të mëtejshme. Mungesa e rrjedhshmërisë së informacionit të përcjellë në rrugë zyrtare ka penalizuar në këtë drejtim raportimin e saktë të të gjitha rasteve të trajtuara nga policia, sidomos për rastet me nivel risku të moderuar dhe të ulët. Kjo problematikë është ngritur edhe nga disa struktura akomoduese për viktimat e dhunës në familje të cilat raportojnë se shpeshherë dokumentacioni i përcjellë nga KVDH, kur rasti referohet tek KVDH nga strukturat e policisë, nuk shoqërohet me të paktën raportin e vlerësimit të riskut ose/dhe vlerësimin e psikologut të DVP kur është e nevojshme. Më konkretisht, nga auditimi i dosjeve²⁸ të të dhunuarve që akomodohen aktualisht pranë Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Grave të Dhunuara vetëm në një rast raporti i vlerësimit të riskut ishte pjesë e dosjes.

Sipas të dhënave të sistemit REVALB, referimet e rasteve edhe nga anëtarë të tjerë të ETN – së, janë në nivele minimale. OJF – të aktive në vendin tonë kanë vendosur vazhdimisht theksin tek mungesa e proaktivitetit të anëtarëve të tjerë të ETN për të identifikuar dhe raportuar pranë KVDH raste të dhunës në familje. Sikurse mund të shihet edhe nga tabela më poshtë (tabela nr. 9), në rang kombëtar policia është institucioni që referon më shumë raste, ndërsa institucionet shëndetësore, institucionet arsimore, përmbarimi dhe zyrat e punës janë ato që referojnë më pak nga të gjithë anëtarët e ETN – ve.

Tabela nr. 9 Numri i referimeve sipas anëtarëve të ETN – ve sipas sistemit REVALB

Emërtimi	2020	2021	2022	2023
Numri i Rasteve të trajtuara	1060	1464	959	449
Numri i Referimeve	2651	3779	2524	820
Numri i rasteve referuar nga Bashkia	516	550	341	116
Numri i rasteve referuar nga Policia	1310	1920	1346	543
Numri i rasteve referuar nga Gjykata	637	973	715	130
Numri i rasteve referuar nga Përmbarimi	3	7	0	0

²⁷ Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, Kreu II, pika 11.

²⁸ Gjatë auditimit janë shqyrtuar 9 dosje të personave të akomoduar në Qendrën Kombëtare për trajtimin e grave të dhunuara.

Numri i rasteve referuar nga Institucionet Arsimore	3	1	0	0
Numri i rasteve referuar nga OJF-lokale	36	64	19	2
Numri i rasteve referuar nga Zyra e Punës	4	3	3	2
Numri i rasteve referuar nga Shërbimi Social	40	149	46	0
Numri i rasteve referuar nga Shëndetësia	5	7	2	5
Numri i rasteve referuar nga Prokuroria	21	20	6	1
Tjetër	1	1	5	0

Burimi: MSHMS

Më konkretisht, në një monitorim të kryer për funksionimin e MKR – së²⁹ në Bashkinë Durrës evidentohet në veçanti se për vitin 2020 dhe 2021 niveli i raportimit të rasteve nga disa anëtarë ETN – së ka qenë si më poshtë:

Përshkrimi	2020	2021
Nr. i raporteve mjekësore për viktimat e dhunës të lëshuara nga ana e Inst. të shëndetësisë	0	0
Nr. i rasteve të raportuara nga mësuesit	0	0

Strukturat vendore të policisë së shtetit nuk kanë dhoma të dedikuara për marrjen e denoncimeve në rastet e dhunës në familje

Në situatat kur personi i dhunuar që paraqitet në polici është i shoqëruar me fëmijë, punonjësi i policisë duhet të kërkojë menjëherë asistencë psikologjike. Gjatë intervistimit të fëmijës kjo lloj asistence është e detyrueshme me qëllim lehtësimin e situatës dhe krijimin e një klime besimi ndaj institucioneve dhe përfaqësuesve të tyre, si dhe siguron që fëmija po trajtohet në mënyrën e duhur. Përveç psikologut, në këto raste njoftohet menjëherë njësia për mbrojtjen e fëmijës dhe/ose punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki, i cili duhet të jetë gjithmonë prezent. Gjatë auditimit në terren në DVP – të e përzgjedhura u konstatua se në rastet e viktimave të dhunës të shoqëruara me fëmijë, pyetja e fëmijëve kryhet në ambiente të dedikuara për ta dhe në kushte të tilla që fëmija të ndihet i lirshëm për tu shprehur, ku ruhet konfidencialiteti i fëmijës dhe respektohen me rigorozitet të drejtat e tij, pavarësisht situatës së dhunës. E njëjtë gjë nuk ndodh në rastet e dhunës kur i dhunuari, kryesisht nëna e dhunuar, nuk shoqërohet me fëmijë. Këto raste zakonisht trajtohen njësoj si denoncimet e tjera pranë strukturave vendore të policisë. Për shembull në DVP Gjirokastrë (komisariati i Gjirokastrës) punonjësit e policisë, në mungesë të një ambienti për të marrë denoncimet shpesh herë, trajtojnë rastet e dhunës në familje në zyrat e specialistëve përkatës e jo në ambiente të dedikuara. Në këto kushte nuk sigurohet trajtimi me respekt dhe dinjitet i viktimave të dhunës, si dhe ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave të tyre personale. Ky shqetësim është ngritur edhe nga OJF aktive në fushën e mbrojtjes së grave viktimave të dhunës në familje, ku evidentohet ndër të tjera pikërisht mungesa e infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e këtyre rasteve, sidomos kur ka edhe fëmijë të përfshirë si dhe kur procedurat zgjasin për një kohë të gjatë.³⁰

Në strukturat vendore të Policisë së Shtetit ndihmës specialistët/specialistët e krimeve që kryejnë menaxhimin fillestar të rasteve të dhunës në familje nuk janë të dedikuar vetëm për këtë funksion

²⁹ AWEN Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri “Funksionimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) në Bashkinë Durrës”, viti 2021.

³⁰ Rekomandime për përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit në Mbrojtje të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Hartuar nga A..... (Rr..... i F.... të G..... Shqipëri), datë 16.12.2021, përcjellë Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Policia e Shtetit, gjatë vitit 2018 realizoi riorganizimin e strukturave dhe funksioneve organike të saj, me qëllim shtrirjen e funksioneve organike “për të miturit dhe dhunën në familje” në të gjitha nivelet nga qendra në bazë. Kjo struktura ka qenë në fuqi për periudhën 2018 – 2023 kur edhe u krye një riorganizimi i ri në këtë drejtim.

Me strukturën e vjetër në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pronës, ka funksionuar Sektori i të Miturve dhe Dhunës në Familje, me përbërje 1(një) Shef Sektori dhe 2(dy) Specialistë. Në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë, në Sektorin për Krimet, ka pasur 1 funksion organik “Specialist, për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje”.

Në Komisariatet e Policisë, në varësi të territorit që mbulojnë dhe numrit të ngjarjeve të evidentuara, ka pasur 1 deri 3 funksione organike “Specialist për hetimin e krimeve dhe për të miturit e dhunën në familje”.

Me riorganizimin dhe ndryshimet strukturore të vitit 2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Sektori Kundër Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve, me përbërje 1(një) Shef Sektori dhe 2(dy) specialistë, ndryshoi varësi dhe kaloi në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë për Krimet në Volum.

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në Sektorin për Krimet në Volum, është Seksioni për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjes së të miturve, me përbërje 1(një) Shef Sektori dhe 2(dy) specialistë. Në 11 Drejtoritë Vendore të Policisë, në Sektorin për Krimet në Volum, në Seksionin për Krimet ka 1 funksion organik “Specialist për dhunën në familje”.

Në Komisariatet e Policisë, në Seksionin për Hetimin e Krimeve në Volum, ka specialistë/ndihmës specialistë për krimet të cilët mbulojnë edhe dhunën në familje dhe të miturit, sipas zonave policore. Funksionet organike shef sektori dhe specialist për dhunën në familje nëpër DVP janë funksione administrative dhe kanë rol koordinues/raportues brenda policisë dhe në kuadër të MKR – së, ndërsa funksioni ndihmës specialist/specialist për krimet është figura profesionale e cila ndeshet me rastin e dhunës në familje dhe nis procedurat për menaxhimin e tij.

Sikurse mund të shihet edhe nga shpjegimi i mësipërm përgjithësisht, Policia e Shtetit edhe pse i ka dhënë përparësi krijimit të strukturave dhe pozicioneve të punës që merren me rastet e dhunës në familje, sidomos në nivelet e saj më operative siç janë komisaritet e policisë, ajo ende nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur këtij funksioni, siç edhe ka ndodhur në vende të tjera fqinje në rajonin tonë. Për shembull, në Kosovë, sipas procedurave standarde të operimit policor për rastet e dhunës në familje, hetuesi primar duhet të merret ekskluzivisht me rastet e dhunës në familje dhe nuk mund të ngarkohet me raste të tjera.³¹ Duhet pasur parasysh se, krahasuar me vendin tonë, Kosova ka një numër rastesh dhune në familje pothuajse 3 herë më të ulët se vendi ynë, me një numër mesatar rastesh në vit prej 2430.³²

Kësaj problematikë i shtohet edhe fakti se në strukturat vendore të Policisë së Shtetit ka lëvizshmëri të lartë stafi. Përgjithësisht këto struktura kanë qarkullime të shpeshta nëpër sektorë të ndryshëm që nuk kanë lidhje me njëri tjetrin. Pavarësisht trajnimeve të vazhdueshme në fushën e ndryshimeve ligjore për dhunën në familje apo edhe çështje të tjera që lidhen me trajtimin e këtyre rasteve, shpesh herë punonjës të trajnuar zëvendësohen me punonjës të pa trajnuar. Kjo situatë nuk favorizon dhënien e një shërbimi efektiv për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

³¹ ZAP Kosovë, Raporti i Auditimit të Performancës, Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, faqe 16, Gusht 2023.

³² ZAP Kosovë, Raporti i Auditimit të Performancës, Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, Grafiku 1, faqe 11, Gusht 2023. Më konkretisht në Kosovë raportohen 2069 raste në vitin 2020, 2456 në vitin 2021 dhe 2759 në vitin 2022.

Baza ligjore dhe rregullatore aktualisht në fuqi nuk parashikon ndërhyrjen e shërbimit psikologjik në fazën e hartimit raportit të vlerësimit të riskut.

Kryerja e vlerësimit psikologjik në rastet e dhunës në familje është një problematikë shumë e rëndësishme e procesit të vlerësimit të riskut nga ana e punonjësit të policisë. Gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të riskut, parashikohet që punonjësi i policisë, së bashku me KVDH kur ky është prezent, shprehet nëse dhunuesi ka probleme të shëndetit mendor. Në këtë kontekst kuptohet që punonjësi i policisë apo edhe KVDH, sa do i trajnuar mbi dhunën me bazë gjinore, nuk janë figurat profesionale të përshtatshme për tu shprehur mbi shëndetin mendor të dhunuesit. Nga ana tjetër në formatin e përcaktuar të raportit të vlerësimit në pjesën ku flitet për të dhunuarin nuk ka asnjë seksion ku të përfshihet nëse edhe i dhunuari vuan nga probleme të shëndetit mendor, ose ka problematika të tjera psikologjike apo psikiatrike të ardhura si rezultat i situatës së dhunës.

Gjatë auditimit në disa institucione rezidenciale (si për shembull në QKVDH) që trajtojnë raste të grave të dhunuara ka rezultuar se të dhunuarat kanë pasur probleme të shëndetit mendor shoqëruese të cilat janë zbuluar gjatë qëndrimit në qendër e që nuk janë evidentuar në momentin e vlerësimit të riskut.³³ Aktualisht, VKM – ja për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, dy udhëzimet e përbashkëta të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë, si dhe Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR – së, nuk parashikojnë ndërhyrjen e psikologut në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut.

Nga ana tjetër evidentohet se, pavarësisht faktit se të gjitha strukturat vendore të policisë kanë të parashikuar në organikë një specialist psikolog, ky nuk është ekskluzivisht i dedikuar për të siguruar kujdes psikologjik për personat e shoqëruar, arrestuar, ndaluar apo për të mitur dhe adult në rastet e dhunës në familje. Ai ka detyrë kryesore, ndër të tjera, të asistojë punonjësit e policisë me ndihmë psikologjike kur është e nevojshme. Me strukturën e vitit 2018, specialisti psikolog në DVP ka pasur detyra më të zgjeruara sa i takon asistimit gjatë marrjes në pyetje, si për shembull: mund të asistonte gjatë marrjes në pyetje të personave të mitur për të lehtësuar komunikimin me punonjësit e policisë dhe të miturin; të kryente procesin e marrjes në pyetje kur i kërkohet duke zbatuar teknikat e intervistimit; apo të asistonte në raste me adult me mendime suicidale, dhunë në familje, përdhunime, dhënie deklarimi që paraqesin probleme psikologjike apo të shëndetit mendor. Me ndryshimet e vitit 2023 në strukturë ka ndryshuar edhe përshkrimi i punës për specialistin psikolog në DVP, duke kufizuar ndërhyrjen e tij vetëm në asistimin me të rritur (me mendime suicidale, viktimitë të dhunës në familje, përdhunime) që paraqesin probleme psikologjike apo të shëndetit mendor dhe referon rastin për vlerësime të mëtejshme.

Pse është e rëndësishme asistenca psikologjike në rastet e dhunës në familje?

Esenciale për një viktimë të dhunës në familje është të ketë mbështetje psikologjike gjatë deklaratës në strukturat vendore të policisë për disa arsye të rëndësishme:

Trauma Emocionale: Dhuna në familje mund të shkaktojë traumë emocionale dhe psikologjike të rënda. Viktimat mund të jenë në një gjendje të tronditjes, frikës, ose ankthit, duke bërë të vështirë për ta të japin deklaratatë të sakta dhe të qëndrueshme. Mbështetja

³³ Nga 9 dosje të marra në shqyrtim në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës, 1 rast është diagnostikuar me problem të shëndetit mendor. Nga intervistat e zhvilluara në terren me stafin e qendrës është shprehur vazhdimisht shqetësimi i mungesës së një vlerësimi psikologjik të mirëfilltë për problematikat e shëndetit mendor të grave të dhunuara gjatë fazës së vlerësimit fillestar të riskut.

psikologjike mund t'u ndihmojë atyre të menaxhojnë emocionet e tyre, të qëndrojnë të qetë, dhe të shprehin veten efektivisht.

Fuqizimi: Viktimat e dhunës në familje shpesh ndihen të pafuqishëm dhe të frikësuar. Duke pasur në dispozicion një profesionist të shëndetit mendor apo një këshilltar emocional gjatë deklaratës mund të ofrojë mbështetje emocionale dhe t'i fuqizojë ata të flasin për përvojat e tyre, rritur kështu mundësinë e raportimit të abuzimit me saktësi.

Memoria dhe Kujtesa: Trauma mund të ndikojë në memorien dhe aftësinë për të kujtuar detajet e ngjarjeve. Mbështetja psikologjike mund t'i ndihmojë viktimat të aksesojnë dhe të shprehin kujtimet e tyre, duke përmirësuar saktësinë e deklaratave dhe duke ndihmuar autoritetet e ligjit të kuptojnë gamën e plotë të dhunës.

Procesi Ligjor: Rastet e dhunës në familje shpesh kërkojnë dokumentacion të gjerë dhe mund të çojnë në procedura ligjore. Deklaratat e sakta dhe të plota janë të rëndësishme për të ndërtuar një rast të fortë. Mbështetja psikologjike mund të ndihmojë viktimat të përballen me procesin ligjor, duke siguruar që ato të japin dëshmi të plota dhe të qëndrueshme.

Besimi dhe Siguria: Viktimat e dhunës në familje mund të kenë probleme me besimin, veçanërisht kur bëhet fjalë për autoritetet. Prania e një profesionisti të shëndetit mendor mund të krijojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, duke nxitur besimin midis viktimës dhe autoriteteve të ligjit, çka është thelbësore për të inkurajuar viktimat të raportojnë dhunën dhe të marrin pjesë në hetimet.

Mirëqenia Afatgjatë: Mbijetuesit e dhunës në familje mund të vuajnë nga efektet psikologjike afatgjata, si sindromi i stresit post - traumatik (PTSD), ankthi, ose depresioni. Mbështetja psikologjike e hershme mund të ndihmojë në zvogëlimin e këtyre efekteve dhe në përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme të viktimës, duke ndihmuar në shërimin dhe procesin të rimarrjes.

Parandalimi i Ri - traumatizimit: Procesi i tregimit të ngjarjeve të dhunës mund të sjellë ri-traumatizim për viktimat. Mbështetja psikologjike mund të ndihmojë viktimat të përballen me barrën emocionale dhe të zvogëlojë rrezikun e përkeqësimit të traumës gjatë deklaratës dhe me tej.

Ndihma psikologjike është një pjesë themelore e mbështetjes së viktimave të dhunës në familje. Duke adresuar efektet e thella psikologjike të dhunës dhe duke ofruar viktimave mjetet për të shëruar dhe për të rindërtuar jetën e tyre, mund të punohet drejt thyerjes së ciklit të dhunës në familje dhe në ndihmë të viktimave në rrugën e tyre drejt shërimin dhe fuqizimit. Është një përgjegjësi e përbashkët të sigurojmë që, ndihma psikologjike të jetë e arritshme për të gjithë ata që kanë përjetuar traumat e dhunës në familje, duke u mundësuar rikthimin në jetën normale dhe për të gjetur shpresë dhe shërim.

Nga auditimi i kryer në DVP – të Kukës dhe Gjirokastrë u evidentua se pozicioni i punës specialist psikolog ishte aktualisht i pa plotësuar, e për rrjedhojë ky shërbim nuk ofrohej sipas përcaktimeve të përshkrimit të punës. Në DVP Tiranë ka 2 psikologë, ndërsa në DVP Durrës ka 1. Në qarkun Gjirokastrë, DVP mbështetej nga urdhri i psikologut sipas nevojave specifike të rasteve që paraqiteshin, ndërsa në DVP Kukës ky shërbim nuk ofrohej.

Nga ana e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me shoqatën N..... për N..... Sh..... A.....³⁴ për të siguruar ofrimin dhe dhënien e ndihmës psikologjike për të miturit gjatë fazës së hetimeve paraprake si dhe shërbimin e emergjencës për të miturit në nevojë për mbrojtje të menjëhershme.

³⁴ Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe N..... për N.....Shoqëror A..... nr. 1784/3, prot., datë 14.04.2023.

Pra sikurse mund të vërehet, mungojnë iniciativat në drejtim të sigurimit të mbështetjes psikologjike në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut si për të dhunuarin ashtu edhe për dhunuesin.

Në 37 bashki të vendit koordinatori vendor i dhunës nuk është i dedikuar për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje

Koordinatori vendor i dhunës është figura thelbësore e mekanizmit të koordinuar të referimit. Në ligjin për dhunën në marrëdhëniet familjare dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kjo figurë është thelbësore në menaxhimin e rasteve pasi, nëpërmjet KVDH i jepet akses viktimave të dhunës në familje në shërbimet e nevojshme në nivel vendor për rehabilitimin e viktimës dhe reintegrimin në shoqëri nëpërmjet arsimit, formimit profesional, punës si dhe shërbimeve të tjera.

Pavarësisht parashikimit të KVDH si thelbësor për mirë administrimin e MKR – së, vërehet se në 37 bashki KVDH nuk merret ekskluzivisht me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ndërsa në 24 bashkitë e tjera KVDH – ja është i dedikuar vetëm për rastet e dhunës.³⁵

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga MSHMS lidhur me KVDH në të gjitha bashkitë e vendit vihet re se vitin e fundit janë zëvendësuar 18 KVDH, të cilët duhet të ri - trajnohen për të kryer funksionet e tyre. Ndërkohë, në Bashkinë Gjirokastrë gjatë vëzhgimit në terren u vërejt se KVDH e këtij institucioni për periudhën nëntor 2021 – e në vijim është alternuar në nga pozicioni i KVDH në pozicionin e punonjësit administrative të Qendrës Emergjente të Viktimave të Dhunës në Familje. Aktualisht KVDH ende rezulton si punonjës administrativ i kësaj qendre, por që mbulon edhe detyrën e KVDH – në Bashkinë Gjirokastrë.


Po kështu edhe në Bashkinë Kukës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka vetëm një specialiste Punonjëse Sociale, e cila kryen edhe rolin e Koordinatorit Vendor për rastet e grave të dhunuara. Kjo bashki nuk ka aktualisht në strukturë një pozicion specifik Koordinator Vendor. Sektori i Mbrojtjes Sociale është struktura që merret me çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare. Në këtë bashki ka 4 PMF dhe 1 KVDH (rol i kryer nga punonjësi social i dhunës).

Mungon një studim i mirëfilltë mbi numrin e nevojshëm të KVDH – ve në raport me numrin e popullsisë dhe numrin e rasteve sipas qarqeve.

Nga një analizë aritmetikore e thjeshtë del në pah që në këtë drejtim ka munguar orientimi i saktë për numrin e nevojshëm të KVDH për të përballuar fluksin e rasteve sipas qarqeve dhe bashkive në raport me popullsinë, Si për shembull në qarkun Tiranë 1 KVDH duhet të mbulojë rreth 185,054 banorë, ndërkohë që në qarqe të tjerë, sikurse mund edhe të vërehet nga grafiku më poshtë, raporti është shumë herë me i reduktuar, por përsëri i pa studiuar.

³⁵ 37 Bashki: Peshkopi, Mat, Klos, Maliq, Kolonjë, Devoll, Kukës, Tropojë, Tepelenë, Dropull, Memaliaj, Këlcyrë, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Mirditë, Kurbin, Berat Skrapar, Kuçovë, Dimal, Gramsh, Gramsh, Belsh, Cërrik, Përrenjas, Peqin, Tiranë, Vorë, Krujë, Shijak, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Divjakë, Himarë, Konispol, Delvinë.

Grafik nr. 3 Numër banorësh qarku për KVDH




Burimi: DPPSH – MSHMS

Duhet theksuar se për kryerjen e një analize të mirëfilltë mbi numrin e nevojshëm të KVDH në raport me popullsinë dhe numrin e rasteve ka disa problematika të natyrës teknike. Të dhënat e sakta mbi numrin e rasteve të dhunës në familje janë vetëm ato të raportuara nga strukturat e Policisë së Shtetit. Vetë MSHMS, si autoritet përgjegjës në këtë fushë, i referohet ekskluzivisht këtyre të dhënave. Nga ana tjetër, Policia raporton të dhëna për numrin e rasteve në rang qarku (sipas Drejtorive Vendore të Policisë) e jo sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu edhe INSTAT, referuar numrit të popullsisë, paraqet të dhëna në nivel qarku e jo në nivel bashkie. Megjithatë për qëllim ilustrimi të situatës në raport me popullsinë dhe numrin e rasteve, janë marrë të dhëna *open source* mbi numrin e përafërt të popullsisë sipas bashkive, nga ku rezulton se Bashkia Tiranë (më e populluara në vendin tonë) ka vetëm 1 KVDH. Qartësisht është e dukshme se ngarkesa e punës së 1 KVDH në NJVQV – në me përqendrimin më të madh të popullsisë në vendin tonë, nuk mund të jetë i njëjtë me Bashkinë Himarë, e cila ka po 1 KVDH dhe njëkohësisht numrin më të ulët të popullsisë në republikë. Po kështu rezulton situata edhe nëse analizojmë treguesit numër KVDH sipas qarqeve dhe numër rastesh për KVDH (në qark)

Në rang qarku të dhënat mbi numrin e koordinatorëve vendor paraqiten si më poshtë:

Grafik nr. 4 Numër KVDH nëpër qarqe



Burimi: MSHMS

Numri i KVDH në nivel qarku varet nga numri i bashkive në total që përbëjnë qarkun. Siç edhe mund të vërehet, qarqet Vlorë, Gjirokastrë, Fier dhe Elbasan kanë numrin më të lartë të KVDH me nga 7 KVDH. Ndërsa qarqet me numrin më të ulët janë ato të Lezhës dhe Kukësit me nga 3 KVDH. Pra, Qarku i Tiranës, i cili ka edhe përqendrimin më të lartë të popullsisë ka më pak KVDH krahasuar me Qarkun e Gjirokastrës.

Ngarkesa e punës për KVDH (shprehur në numër rastesh) paraqitet po njësoj, nga ku rezulton se mesatarisht 1 KVDH në Tiranë menaxhon 326 raste, ndërkohë që një KVDH në qarkun Gjirokastrë menaxhon 11 raste.

Komiteti Drejtues nuk mbledhet rregullisht për të ushtruar funksionet e tij.

Komiteti Drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje është një organ i cili duhet të ngrihet dhe të funksionojë pranë çdo bashkie. Gjatë këtij auditimi ka rezultuar se, pavarësisht ngritjes së tij në ato bashki ku është ngritur MKR, ky organ nuk është mbledhur rregullisht, çdo tre muaj ose në mbledhje të jashtëzakonshme sipas nevojave. Më konkretisht për periudhën 2020 – 2022, në bashkinë Durrës, KD është mbledhur në total 3 herë, ndërkohë që ka pasur takime më të shpeshta në nivel ETN – je, 6 herë në vitin 2020, 10 herë në vitin 2021 dhe 12 në vitin 2022.

Tabela nr. 10 Takime ETN, GTN, KD

Bashki	2020			2021			2022		
	Takime MKR	Takime KD	Takime ETN	Takime MKR	Takime KD	Takime ETN	Takime MKR	Takime KD	Takime ETN/GTN
Bashkia Durrës	7	1	6	11	1	10	12	1	11
Bashkia Kukës	-	-	-	-	-	7	-	-	8
Bashkia Gjirokastrë	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: B. Durrës, Gjirokastrë, Kukës

Sikurse mund të vihet re, ka pasivitet dhe mungesë angazhimi nga KD për të ushtruar funksionet që parashikohen në kuadër të MKR, krahasuar me ETN, që rezulton të jetë më aktiv në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. VKM nr. 327 parashikon për këtë organ, përveç detyrimit për tu mbledhur dhe pjesëmarrjen e detyrueshme të të gjithë anëtarëve të mekanizmit, një sërë kompetencash dhe detyrash që duhet të ushtrojnë në nivel vendor për të udhëhequr MKR – në. Ndër të tjera, ky organ duhet të analizojë efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës e shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor në varësi të funksioneve e të përgjegjësisë që ka secili anëtar i komitetit drejtues; duke vlerësuar veprimtarinë e ETN – së etj. Nga auditimi i minutave të takimit të mbledhjeve të KD në Bashkinë Durrës evidentohet se këto takime janë përgjithësisht formale, me fjali dhe shprehje të përsëritura nga takimi në takim nga ku nuk evidentohet orientim apo vendimmarrje për punën dhe mënyrën se si duhet të funksionojë mekanizmi në nivel vendor. Ndërkohë, Bashkitë Kukës dhe Gjirokastrë nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacionin përkatës që eidenton mbledhjen dhe funksionimin e duhur të KD në këto dy bashki.

Mos funksionimi i KD si organ udhëheqës i MKR – së në bashkitë objekt i këtij auditimi tregon konkretisht se në këto bashki nuk janë shfrytëzuar mundësitë për të ofruar shërbime dhe alternativa mbështetjeje për viktimat e dhunës në familje dhe për rehabilitimin e dhunuesve.

Më konkretisht në Bashkinë Durrës, e cila ka numrin më të lartë të rasteve pas Bashkisë Tiranë, për shkak të angazhimit të vakët të KD – në këtë drejtim nuk janë gjetur zgjidhje konkrete për vonesat në akordimin e bonusit të qerasë për gratë e dhunuara si dhe nuk janë shfrytëzuar

maksimalisht mundësitë për bashkëpunim me OJF lokale dhe kombëtarë në fushën e dhunës me bazë gjinore për të ofruar alternativa shërbimesh dhe akomodimi emergjent apo edhe afatgjatë për gratë e dhunuara, ndërkohë që nuk ofrohet asnjë program rehabilitimi për dhunuesit. Po kështu nuk është planifikuar apo propozuar ngritja e një shërbimi të dedikuar për gratë e dhunuara qoftë me fondet e bashkisë apo edhe në bashkëpunim me MSHMS (nëpërmjet fondit social) ose OJF të tjera. Aktualisht në këtë bashki është ngritur dhe funksionon vetëm Qendra për Shërbime Mbrotjtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen në të cilën janë akomoduar në situata të jashtëzakonshme edhe raste të grave të dhunuara (me ose pa fëmijë) pavarësisht faktit se kjo qendër nuk është e dedikuar për këtë funksion. Fokusi i saj i punës janë kryesisht shërbimet për fëmijët (rezidencial) dhe familjen (nëpërmjet aktiviteteve për prindërimin pozitiv apo të tjera).³⁶

Duhet theksuar se angazhimi financiar i Bashkisë në këtë qendër është minimal, pasi ajo mbulon vetëm pagat e punonjësve, ndërkohë që shpenzimet e tjera për ushqim, pako ushqimore apo punonjës me kontratë mbulohen nga W.... V..... Falë angazhimit të OJF – së është bërë i mundur funksionimi i vazhdueshëm i kësaj qendre, e cila disponon ambiente të mirë arregduara dhe me kushte të mira për të ofruar shërbim për fëmijët dhe familjen. Pavarësisht kësaj, duhet evidentuar se për shkak të hapësirave dhe mundësive akomoduere të kushtëzuara (numër shtretërisht), në këtë qendër nuk është e mundur ndarja e banorëve që akomodohen sipas gjinisë, sipas grupmoshave, apo kategorisë në nevojë, gjë kjo e nevojshme për të shmangur konflikte të mundshme dhe menaxhim sa më të mirë të rasteve që paraqiten nga stafi i saj (kategori të ndryshme në nevojë kërkojnë qasje dhe zgjidhje të ndryshme.

Kjo qendër ofron edhe kurse të ndryshme ditore në mbështetje të familjes dhe fëmijëve për të promovuar mirëqenien e komunitetit. Në këto kushte, është e vështirë ruajtja e fshehtësisë së vendndodhjes dhe konfidencialitetit të banorëve të akomoduar aty nga ana e stafit të qendrës.³⁷

Me të njëjtat problematika shfaqet situata edhe në Bashkinë Kukës, ku është ngritur Strehëza e emergjencës për gratë e dhunuara (financim i mundësuar nëpërmjet Fondit Social). Kjo strehëz përbëhet nga një dhomë me dy shtretër e vendosur brenda të njëjtës godinë ku gjenden edhe zyrat e tjera të Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Kukës. Edhe kjo qendër nuk është e dedikuar vetëm për dhunën në familje, por përdoret nga bashkia dhe për shërbime të tjera si ato të PAK - ut. Kjo qendër mundëson vetëm strehim emergjent, ndërkohë nga bashkia nuk është garantuar buxhet për ushqim dhe veshmbathje, të nevojshme në momentin e strehimit të personave të personave të dhunuar. I vetmi rast bashkëpunimi në zonë është ai me OJF “Të n.....të b.....” e cila ndihmon në mbulimin e bonusit të qerasë për viktimat e dhunës.³⁸

1- Gjetje nga auditimi: Në rolin e vet si institucion politik bërës, vëzhgues e monitorues (nëpërmjet institucioneve përkatëse të varësisë) të mekanizmit të ngritur për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje me të gjitha nuancat institucionale e shoqërore që mbartin këto, vërehet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale nuk arrin të kryejë analiza të thella dhe domethënëse për situatën aktuale të këtij mekanizmi dhe shërbimeve që janë mundësuar në nivel kombëtar dhe lokal për përballimin e kësaj patologjie sociale. Konkretisht, sistemi REVALB nuk është fuqizuar dhe nuk është siguruar lidhja me sisteme të tjera relevante të mbledhjes së të dhënave, si SSHKSH (Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror). Gjithashtu, në vendin tonë ende nuk ka asnjë shërbim të ngritur për strehimin/rehabilitimin e dhunuesit në momentin kur urdhërohet largimi i menjëhershëm nga banesa.

1. Konkluzion: Mungesa e analizave të thelluara në drejtim të arritjeve, dështimeve, mundësive kapaciteteve etj nuk ka lejuar që MSHMS të kryejë një lexim të qartë dhe objektiv

³⁶ Vizitë në terren në Bashkinë Durrës datë 26.09.2023.

³⁷ Vizitë në terren në Qendrën për Sh..... M....., F..... dhe E..... për F..... dhe F....., datë 11.10.2023.

³⁸ Vizitë në terren pranë Bashkisë Kukës datë 05.10.2023.

të situatës së mekanizmit në rang vendit, si dhe të shërbimeve të nevojshme që duhen ngritur në nivel qendror dhe lokal për menaxhimin e rasave të dhunës në familje.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të kryejë një vlerësim të thelluar të Mekanizmit duke i kushtuar një rëndësi të veçantë angazhimit real të anëtarëve të mekanizmit, nevojave për shërbime e financime sipas karakteristikave të qarqeve e bashkive, me qëllim identifikimin e saktë të ndërhyrjeve të nevojshme për fuqizimin e mekanizmit të tij.

Brenda datës 31.12.2024

2- Gjetje nga auditimi: Midis anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor që trajton rastet e dhunës në familje dhe Koordinatorëve Vendor në bashki për referimin e rasteve të dhunës, ka munguar ndërveprimi dhe komunikimi i duhur zyrtar në dy drejtime. Së pari, strukturat vendore të Policisë së Shtetit nuk përcjellin (në të gjitha rastet që referojnë) raportin e vlerësimit të riskut pranë KVDH - së, për arsye se, sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje³⁹, një kopje e raportit të vlerësimit të riskut i jepet, përveç titullarit të strukturës përgjegjëse (policisë) dhe punonjësve (kryesisht KVDH) që thirren për hartimin e këtij raporti. KVDH nuk ka detyrimin të jetë prezent gjithmonë në momentin e vlerësimit të riskut në polici. Së dyti, evidentohet se referimet e institucioneve të tjera anëtarë të ETN – së janë në nivele minimale, krahasimisht me Policinë e Shtetit.

2. Konkluzioni: Mungesa e ndërveprimit dhe komunikimit zyrtar midis anëtarëve të ETN – së dhe KVDH nuk ka mundësuar pasqyrimin e saktë të situatës së dhunës në familje në vendin tonë jo vetëm për ato raste që evidentohen, por sidomos për rastet të cilat nuk referohen dhe nuk trajtohen nga strukturat për shkak të pasivitetit të anëtarëve të ndryshëm të ETN – së.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Ministrinë e Brendshme të rishikojnë Udhëzimin e Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, për të përcjellë në çdo rast raportin e vlerësimit të riskut koordinatorit vendor të dhunës në bashki.

Brenda datës 30.06.2024

3- Gjetje nga auditimi: Strukturat vendore të Policisë së Shtetit nuk kanë dhoma të dedikuara për marrjen e denoncimeve në rastet e dhunës në familje. Rastet e dhunës në familje trajtohen njësoj si denoncimet e tjera pranë strukturave vendore të policisë. Në DVP Gjirokastrë (Komisariati Gjirokastrë) punonjësit e policisë, në mungesë të një ambienti për të marrë denoncimet, shpesh herë trajtojnë rastet e dhunës në familje në zyrat e specialistëve përkatës e jo në ambiente të dedikuara.

3. Konkluzioni: Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nuk ka siguruar trajtimin me respekt dhe dinjitet të viktimave të dhunës, si dhe ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për të siguruar kushtet infrastrukturore të përshtatshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje me qëllim trajtimin me respekt e dinjitet dhe ruajtjen e fshehtësisë dhe konfidencialitetin.

Brenda datës 30.06.2024

³⁹ Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, Kreu II, pika 11.

4- Gjetje nga auditimi: Në strukturat vendore të Policisë së Shtetit ndihmës specialistët/specialistët e krimeve që kryejnë menaxhimin fillestar të rasteve të dhunës në familje nuk janë të dedikuar vetëm për këtë funksion. Policia e Shtetit, edhe pse i ka dhënë përparësi krijimit të këtyre funksioneve, ende nuk i jep rëndësinë e duhur këtij funksioni, siç edhe ka ndodhur në vende të tjera fqinje në rajonin tonë, ku kjo figurë është e dedikuar.

4. Konkluzioni: Në kushtet e dinamicitetit të strukturave vendore të Policisë së Shtetit, mos parashikimi i një punonjësi të dedikuar për të trajtuar rastet e dhunës në familje nuk favorizon dhënien e një shërbimi efektiv për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të ngrejë grup pune për të vlerësuar krijimin e funksionit të dedikuar specialist/ndihmës specialist për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Brenda datës 30.06.2024

5- Gjetje nga auditimi: Baza ligjore dhe rregullatore aktualisht në fuqi nuk parashikon ndërhyrjen e shërbimit psikologjik në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut. VKM – ja për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, dy udhëzimet e përbashkëta të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë, si dhe Protokolli i menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR – së, nuk parashikojnë ndërhyrjen e psikologut në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut.

5. Konkluzioni: Mungesa e shërbimit psikologjik gjatë fazës së vlerësimit të riskut penalizon marrjen e deponimeve të sakta dhe të qëndrueshme nga viktimat pasi trauma mund të ndikojë në memorien dhe aftësinë për të kujtuar detajet e ngjarjeve. Mbështetja psikologjike mund t'i ndihmojë viktimat të aksesojnë dhe të shprehin kujtimet e tyre, duke përmirësuar saktësinë e deklaratave dhe duke ndihmuar autoritetet e ligjit të kuptojnë gamën e plotë të dhunës.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore rregullatore për përfshirjen e vlerësimit psikologjik gjatë fazës së vlerësimit të riskut për viktimat e dhunës në familje.

Brenda datës 31.12.2024

6- Gjetje nga auditimi: Në 37 bashki të vendit koordinatori vendor i dhunës nuk është i dedikuar për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje. Në Bashkinë Gjirokastrë, KVDH për periudhën nëntor 2021 – e në vijim është alternuar nga pozicioni i KVDH në pozicionin e punonjësit administrativ të Qendrës Emergjente të Viktimave të Dhunës në Familje. Aktualisht KVDH ende rezulton si punonjës administrativ i kësaj qendre, por që mbulon edhe detyrën e KVDH – së në Bashkinë Gjirokastrë. Po kështu, në Bashkinë Kukës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka vetëm një specialiste Punonjëse Sociale, e cila kryen edhe rolin e Koordinatorit Vendor për rastet e grave të dhunuara. Kjo bashki nuk ka aktualisht në strukturë një pozicion specifik Koordinator Vendor. Gjithashtu, rezulton se vitin e fundit në rang republike janë zëvendësuar 18 KVDH, të cilët duhet të ri - trajnohen për të kryer funksionet e tyre.

6. Konkluzioni: Mbivendosja e funksioneve të tjera me atë të KVDH – së nuk lejon një menaxhim të duhur të rasteve në nivel vendor duke penalizuar cilësinë e punës dhe përkushtimin e kësaj figure profesionale vetëm në drejtim të MKR – së.

6.1 Rekomandimi: Bashkitë Gjirokastrë dhe Kukës të përfshijnë në strukturat e tyre Koordinatorin vendor të dhunës si funksion më vetë, pa mbivendosje me funksione të tjera në fushën e barazisë gjinore.

Brenda datës 30.06.2024

7- Gjetje nga auditimi: Komitetet Drejtuese të mekanizmit të koordinuar të referimit në nivel bashkie nuk mbledhen rregullisht për të ushtruar funksionet e tyre. Gjatë këtij auditimi ka rezultuar se, pavarësisht ngritjes së tyre në ato bashki ku është ngritur MKR, ky organ nuk është mbledhur rregullisht, çdo tre muaj ose në mbledhje të jashtëzakonshme sipas nevojave. Më konkretisht për periudhën 2020 – 2022, në bashkinë Durrës, KD është mbledhur në total 3 herë, ndërkohë që ka pasur takime më të shpeshta në nivel ETN – je, 6 herë në vitin 2020, 10 herë në vitin 2021 dhe 12 në vitin 2022. Ndërkohë, në Bashkitë Kukës dhe Gjirokastrë nuk ka gjurmë të mbledhjes dhe funksionimit të duhur të KD.

7. Konkluzioni: Pasiviteti dhe mungesa e angazhimit nga Komiteti Drejtues për të ushtruar funksionet që parashikohen në kuadër të MKR – së ka privuar mekanizmin nga orientimi i duhur dhe vendimmarrja në drejtim të fuqizimit të tij.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ngrejë një grup pune për të kryer një monitorim të mirëfilltë të funksionimit të MKR – së në Bashkitë Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë, përfshirë këtu në veçanti veprimtarinë e Komitetit Drejtues dhe angazhimit të tij për mirëfunksionimin e mekanizmit.

Brenda datës 30.06.2024

5.2.2 A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit të procesit?

Analiza e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit të dhunës në familje është jetike për të shënuar përparimin dhe për të garantuar një rrjedhje efikase të informacionit ndërmjet institucioneve. Studimi i këtyre sistemeve jo vetëm që zbulon mangësitë dhe sfidat e mundshme, por edhe kontribuon në forcimin e përgjegjshmërisë së institucioneve karshi detyrave të tyre. Ky proces është i domosdoshëm për të kultivuar besimin e qytetarëve, siguruar një përdorim optimal të burimeve të dedikuara për këtë çështje dhe për të konfirmuar se strategjitë e zbatuara janë të suksesshme në përmirësimin e standardeve të shërbimit dhe në reduktimin e dhunës në familje.

Gjatë auditimit u morën në konsideratë disa komponentë kryesore si; nëse përdorimi i aplikacioneve të teknologjisë për mbledhjen e të dhënave, monitorimit dhe vlerësimi i performancës së tyre është në një linjë me objektivat e SKBGJ 2021-2030 dhe konventën e OKB; nëse janë hartuar raporte monitorimi periodike të proceseve e mekanizmave të dhunës në familje që nga evidentimi deri në trajtimin me shërbime; nëse ato janë të sakta dhe të plota dhe nëse raportet e sistemit japin një pasqyrë të detajuar të të dhënave dhe të performancës së procesit.


Funksionimi i monitorimit e përdorimi i sistemit REVALB për evidentimin rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje është dobësuar.

Sipas marrëveshjes së Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi trajtimin e dhunës ndaj grave, është jetike që shtetet të krijojnë dhe menaxhojnë një infrastrukturë informacioni që regjistron dhe analizon rastet e dhunës kundër grave. Kjo do të thotë jo vetëm regjistrimin e ankesave, urdhrave për mbrojtje dhe ndihmës shtetërore që ofrohet për viktimat, por edhe dokumentimin e dënimeve dhe ndëshkimeve për autorët e kësaj dhune. Përtej kësaj, marrëveshja kërkon që

shtetet anëtare të ndihmojnë në hulumtime dhe studime mbi këtë problematikë për të kuptuar më thellësisht origjinën dhe pasojat e dhunës ndaj grave.⁴⁰

Mbledhja e të dhënave mbi rastet e dhunës në familje dhe menaxhimi i tyre në një mënyrë të koordinuar shumë-disiplinore është një ndër hapat kryesorë për të garantuar një zbatim efektiv të marrëveshjes. Sistemi REVALB ka një rol kritik në këtë proces. Ai duhet të pasqyrojë informacionin e përditësuar dhe të plotë mbi këto raste, sipas SKBGJ. Një përpjekje konstante duhet të bëhet për fuqizimin dhe përmirësimin e këtij sistemi dhe përdoruesve/përdoruesve të tij⁴¹. Kjo përfshin edhe ndërlidhjen e REVALB me sisteme të tjera shtetërore dhe kalimin në një baze të dhënash të qëndrueshme dhe të integruar nën menaxhimin e AKSH-it⁴². Kjo do të ndihmojë jo vetëm në monitorimin dhe vlerësimin e situatës aktuale, por do të kontribuojë edhe në marrjen e vendimeve më të informuara për të adresuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave në të ardhmen.

Figura nr. 6



Punoi Grupi i auditimit; Raportimi dhe komunikimi i informacionit.

Sistemi REVALB për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje është një mjet i vlefshëm për monitorim dhe analizë. Ky sistem mund të përdoret për të identifikuar trendet dhe ndryshimet në rastet e dhunës në familje, duke ofruar raporte periodike që tregojnë të dhënat kryesore dhe për të identifikuar sfidat si, zonat më të prekura ose mungesa e raportimit të rasteve. Gjithashtu, duke monitoruar mekanizmat e referimit dhe shërbimet shoqërore që janë ofruar, MSHMS mund të vlerësojë efikasitetin e koordinimit dhe të marrë masa për të adresuar çdo sfidë që identifikohet, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e politikave dhe praktikave ekzistuese. MSHMS e administron sistemin nën mbështetjen e konsulencës e UNDP⁴³. Nëpërmjet përditësimit të sistemit nga KVDH ai u ofron autoriteteve lokale dhe atyre kombëtare një mekanizëm monitorimi dhe lejon mbledhjen e të dhënave nga të gjitha bashkitë e vendit. Kjo mundëson një reagim më të shpejtë dhe të koordinuar ndaj situatave të rrezikshme të dhunës në familje.

⁴⁰ Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË)

⁴¹ Sistemi REVALB dhe përdorueset /përdoruesit e tij të fuqizuar; brenda 6 mujorit të dytë 2022

⁴² Sistemi i menaxhuar tërësisht nga autoriteti kryesor përgjegjës Brenda 6 mujorit të dytë 2030

⁴³ United Nation Development Program

Brenda strukturës së MSHMS, njësia përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje është Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në varësi të saj ka Sektorin e Politikave të Barazisë Gjinore. Misioni i këtij sektori është hartimi, zhvillimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave dhe strategjive/planeve kombëtare që synojnë përforcimin e barazisë gjinore dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Një pjesë thelbësore e detyrave të këtij sektori, të specialistëve të tij, është monitorimi dhe administrimi i sistemit REVALB me mbështetjen e specialistëve të PNUDP-it.

Sektori është i përbërë nga tre anëtarë: një përgjegjës/e i/e sektorit dhe dy specialistë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se një pozicion specialisti është vakant prej shumë vitesh, gjë që mund të ndikojë në kapacitetin e plotë të sektorit për të menaxhuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij, veçanërisht në lidhje me administrimin dhe analizën e të dhënave nga sistemi REVALB.

Nga rishqyrtimi raporteve kryesore të sistemit REVALB në dispozicion, me qëllim të kuptuarit e shtrirjes dhe frekuencës së përdorimit të sistemit në 61 bashkitë e vendit, u analizua shkalla e përdorimit të sistemit.


Nga analiza u konstatua se, në vitin 2020, një vit i shënuar nga pandemia Covid 19, nga 61 bashki gjithsej në vendin tonë, 41 prej tyre ose afërsisht 67% kanë përdorur sistemin e informacionit REVALB për regjistrimin e rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje. Ndërsa, 33% e bashkive (Dropull, Finiq, Gramsh, Këlcyrë, Konispol, Krujë, Librazhd, Mallakastër, Mirditë, Peqin, Peshkopi, Poliçan, Skrapar, Tepelenë, Tropojë, Vorë etj), nuk e kanë përdorur sistemin.

Gjatë vitit 2021, përqindja e bashkive që përdorën sistemin REVALB zbriti me një bashki ose afërsisht 66% shkallë përdorimi. Megjithatë gjatën këtij viti, ka ndryshime të rëndësishme në bashkitë specifike që e përdorën sistemin: Pesë bashki (Devoll, Dropull, Konispol, Poliçan, Skrapar) u rikthyen në sistemin REVALB pas një viti pauze, ndërsa gjashtë bashki të tjera (Elbasan, Laç, Përmet, Pustec, Rrogozhinë, Shijak,) duke filluar nga Elbasan i cili është një qendër e madhe, nuk e përdorën sistemin.

Në vitin 2022, përdorimi i REVALB nga bashkitë ra më tej në rreth 51%. Në këtë vit, 12 bashki (Fushë Arrëz, Kamës, Kolonjë, Libohovë, Maliq, Mat, Memaliaj, Pukë, Roskovec, Vau Dejës, Poliçan, Skrapar) që kishin qenë aktive një vit më parë nuk e përdorën më atë, ndërsa 3 bashki (Devoll, Dropull, Konispol,) të tjera “vendosën” të rikthehen.

Duke shkuar më tej, deri në Tetor të vitit 2023, përdorimi i REVALB ra ndjeshëm, duke arritur në një pikë të ulët historike me vetëm 19 bashki ose vetëm rreth 31% të bashkive regjistruan të dhëna. Sistemi nuk u përdorur nga 12 bashki të tjera (Devoll, Dropull, Konispol, Poliçan, Skrapar, Lushnje, Patos, Sarandë, Shkodër, Vlorë, Delvine, Elbasan) krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie tregon një humbje besimi ndaj një mjeti që ka synuar të ndihmonte bashkitë me menaxhimin e të dhënave të të mbijetuarave nga dhuna në familje. Bashkitë e mëdha si Shkodra dhe Vlora, të njohura për ndikimin dhe rëndësinë e tyre aktualisht nuk regjistrojnë të dhëna në sistemin REVALB.

Grafiku nr 5.



Burimi MSHMS, përpunoi grupi i auditimit.

Nga ana tjetër detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit në lidhje me REVALB nuk përcaktohen qartë në rregulloren e brendshme të MSHMS, si dhe të jenë të integruara në përshkrimet e punës së specialistëve të sektorit. Gjithashtu sistemi i raportimit dhe monitorimit të dhunës në familje, ka një sërë mungesash si: Nuk janë kryer monitorime nga MSHMS, për pasojë nuk ka raporte të monitorimeve dhe vlerësimeve të mëparshme të sistemit dhe situatës, elemente që do të mundësonin një pasqyrë të performancës historike dhe sfidave të njohura të sistemit dhe do të mundësonin marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Mungon feedback-u dhe regjistrimi i ankesave nga përdoruesit e sistemit, duke mos lejuar një analizë të thelluar të përvojës së tyre me sistemin dhe incidentet që kanë hasur. Kanë munguar marrja në analizë e raporteve periodike nga sistemi, të cilat janë të rëndësishme për të pasur një vështrim të qartë mbi funksionimin e sistemit gjatë kohës dhe marrja e masave për përmirësimin e situatës. Gjithashtu mungojnë minuta-takimet e raportet që lidhen me menaxhimin e këtij sistemi, duke lënë pa trajtuar, problematikën e informimit për vendimmarrësit, duke rritur vështirësitë dhe marrjen e vendimeve. Sa më sipër, nuk kanë funksionuar monitorimi dhe mbikëqyrja e sistemit të mbledhjes së të dhënave (REVALB) në MSHMS, si rezultat ka ndikuar në mos vlerësimin e situatës dhe marrjen e masave për rritjen e përdorimit të sistemit REVALB në vite nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Si përfundim një numër i rëndësishëm i bashkive po shmang të përdorë sistemin REVALB, kjo sjell për pasojë, ulje të efektivitetit duke mos realizuar objektivat e SKBGJ, mungesë monitorimi dhe zbatimi i sistemit e politikave publike të destinuara për të mbrojtur të mbijetuarat e dhunës në familje. Një mungesë të dhënash të sakta, të plota dhe të përditësuara për gjithë vendin mund të ndikojë direkt në aftësinë e institucioneve për të bërë monitorime dhe analiza në mënyrë që të rishpërndahen burimet për të ndihmuar të mbijetuarat e dhunës në familje ku ka nevojë.

Monitorimi e raportimi nga Komiteti drejtues në nivel NJVQV nuk ka funksionuar mirë.

Në lidhje me sistemin të monitorimit në bashki, u vlerësuan aktivitetet e monitorimit e raportimit në nivel lokal. Veçanërisht është verifikuar mënyra e përditësimit të të dhënave nga “koordinatorët vendore” (KV) të dhunës në familje dhe raportimet mujore tek “komiteti drejtues” (KD) dhe tremujore nga ky i fundit tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). . Për këtë qëllim u morën në vlerësim tre bashki (Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë) të cilat, sispas raporteve kanë përditësuar e përdorur sistemin REVALB gjatë kësaj periudhe. Nga bashkitë Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë, strukturat monitoruese audituese nuk kanë parashikuar në programet e tyre të monitorimit dhe auditimit aspekte të veprimtarisë së MKR-së për periudhën, për pasojë nuk kanë të trajtuar vlerësimin e MKR-së në raportet përkatëse.

Komiteti drejtues i MKR-së në nivelin lokal ka për detyrë menaxhimin dhe monitorimin e dhunës në familje dhe është kryesuar nga kryetari i bashkisë. Ky komitet koordinon analizën e të dhënave të dhunës në familje, veçanërisht ato nga sistemi REVALB dhe duhet të raportojë çdo tre muaj tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me gjithë rëndësinë dhe kompetencat e komitetit drejtues, nga auditimi i Bashkive Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë u konstatuan mungesa në zbatimin e detyrave. Kështu, Komiteti Drejtues i këtyre bashkive është mbledhur një herë në vit në vend të katër herëve, dhe ka pasur mungesa në raportimin periodik në MSHMS, duke krijuar pasiguri në monitorimin e dhunës në familje.

Entiteti Teknik Ndërdisciplinorë, kryesuar nga KV, është një element kyç i MKR-së për menaxhimin e dhunës në familje. Ky entitet është përgjegjës për mbledhjen, analizën dhe raportimin e rasteve të dhunës, duke garantuar aktualizimin e të dhënave dhe reflektimin e realitetit në terren. Megjithatë ka një rol të theksuar në koordinimin dhe komunikimin me institucionet e MKR-së në nivel lokal, nga auditimi në Bashkinë Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë u konstatuan mungesa në monitorimin e raportimin mujor me shkrim të përfaqësuesve të institucioneve në përbërje të ETN-së për titullarët e këtyre institucioneve lidhur me veprimtarinë dhe mbledhjet e ETN-së, rastet që janë referuar dhe mënyrën e menaxhimit të tyre; Kjo ka rezultuar në një komunikim të pamjaftueshëm dhe mungesa të raportimit mujor të informacionit, duke e lënë një pjesë të institucioneve nga ata vijnë, pa të dhëna të plota.

Koordinatori vendor është një pjesë kyçe e MKR-së, i cili merret me koordinimin dhe raportimin e dhunës në familje. Ai është përgjegjës për menaxhimin e rasteve, regjistrimin dhe integritetin e të dhënave në sistemin REVALB, duke ruajtur konfidencialitetin. Gjithashtu, koordinatori vendor duhet të ndajë informacionin me ekipin ETN dhe “komitetin drejtues”, dhe të raportojë bazuar në të dhënat e mbledhura nga REVALB. Megjithatë, nga auditimi u konstatuan mungesa dhe sfida në zbatimin e detyrave. Disa problematika u identifikuan në Bashkinë Gjirokastrë dhe Durrës lidhur me përditësimin dhe regjistrimin e të dhënave, të dhënat në Bashkinë Durrës përditësohen në fund të çdo muaji, ndërsa të dhënat në Bashkinë Gjirokastrë për 2023 janë përditësuar gjatë muajit Shtatorë. Përdorimi i raporteve të printuara nga REVALB nuk është i zakonshëm, dhe shpesh të dhënat eksportohen dhe përpunohen në Excel, duke krijuar pasaktësi dhe mungese ruajtje konfidencialiteti. Ndërkohë, dy koordinatorët vendor të bashkisë Durrës kanë të njëjtat kredenciale log in në sistem. Koordinatori i Bashkisë Kukës ka raportuar rregullisht në bashki, por ka munguar analiza e detajuar dhe propozime konkrete për adresimin e sfidave, gjithashtu raportet nuk janë shqyrtuar nga komiteti drejtues. Sa më lart në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore mungojnë, monitorimi dhe auditimi i aktivitetit e MKR-së, raporti periodik nga komiteti drejtues drejt MSHMS-së, përditësimi sistematik i sistemit REVALB dhe printimi i raporteve direkt nga sistemi etj. Një ndër shkaqet më kryesore veçojmë mungesën e mbikëqyrjes dhe ndërgjegjësimit të njësive të vetëqeverisjes vendore për rëndësinë dhe obligimin e tyre për të evidentuar, monitoruar, audituar dhe raportuar rregullisht veprimtaritë dhe të dhënat lidhur me dhunën në familje. Kjo ka çuar në mos përmbushjen e detyrave të monitorimit e të raportimit dhe përditësimit të të dhënave rast pas rasti në sistemin REVALB, duke e bërë të vështirë njohjen e shtrirjes së dhunës në familje nga NJVQV, dhe ndërhyrjen efektive për ta parandaluar dhe trajtuar atë në komunitet.

Programet e monitorimit dhe më pas raportet e monitorimit nga SHSSH të projekteve sociale “strehëzave” janë formale.

Strehëzat⁴⁴ për mbrojtjen dhe rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës në familje të ngritura në disa bashki ofrojnë shërbim në mënyrë të përkohshme në varësi të nevojave të identifikuar

⁴⁴ Institucionesh të Përkujdesit Shoqëror ku strehohen me një afat 72 ore të mbijetuarat e dhunës në familje sispas vlerësimit.

dhe të zgjedhura nga përfituesit të mbijetuarat e dhunës në familje, që kanë marrë “urdhër mbrojtje” apo “urdhër të menjëhershëm mbrojtje,” ju siguron atyre: strehimin; sigurinë fizike; ushqimin; kujdesin shëndetësor; asistencë juridike; rehabilitimin psiko-social etj.

Drejtoria Shërbimi Social Shtetëror pranë SHSSH vë në zbatim monitorimin e aktivitetit të tyre, i cili ka për qëllim të sigurojë se standardet kombëtare për shërbimet sociale zbatohen me kujdes nga “njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mbijetuarat e dhunës në familje. Kjo drejtori është ndarë në tre sektorë kryesorë.

Sektori i parë është Sektori i Shërbimeve Sociale për Fëmijë, i drejtuar nga një Përgjegjës Sektori dhe ka gjithashtu dy specialistë. Sektori i dytë është Sektori i Shërbimeve Sociale për të rritur, po ashtu i drejtuar nga një Përgjegjës Sektori dhe përfshin dy specialistë. Ndërsa sektori i tretë është Sektori i Koordinimit dhe referimit me komisionet shumë disiplinore të AK-së. Ky sektor drejtohet nga një Përgjegjës Sektori dhe përfshin dy specialist ku njëri specialist është IT.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, në përputhje me kërkesat administrative sipas rregulloreve dhe përshkrimit të punës, është e detyruar të përgatisë një plan vjetor të monitorimeve përpara se të hartojë programet e monitorimit për çdo strehëz. Procesi i monitorimit duhet të realizohet duke ndjekur metodologjinë e miratuar⁴⁵.

Plani vjetor i monitorimit është një dokument i detajuar që përcakton objektivat dhe pritshmërinë për monitorimin gjatë një viti kalendarik. Ky plan identifikon sektorët, shërbimet, apo aktivitetet që duhet të monitorohen, përcakton metodologjinë e monitorimit dhe resurset e nevojshme për të mbuluar çdo fushë të specifikuar. Nga auditimi rezultoi se plani vjetor i monitorimit për periudhën nuk është hartuar nga SHSSH.

Pavarësisht kësaj SHSSH me kërkesë të MSHMS-së ka kryer monitorime me baze vjetore për projektet strehëza në administrim të disa NJQV-ve si Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë, Qarku Tiranë, për cdo monitorim është hartuar një program monitorimi, i cili është gati i njëjtë për të gjitha strehëzat, Ky program ka një fokus tematik-financiar të thjeshtë dhe synon të zbatohet brenda një periudhe dy ditore.

DRSHS Gjirokastrë	DRSHS Kukës	DRSHS Tiranë	Linja telefonike, keshillimit Tirane
3 raporte mbi monitorimin e kryer (2021-2023)	1 raport monitorimi 2022	2 raporte monitorimi në QKTVDHF (2021-2022)	3 raporte monitorimi (2021-2023)

Më poshtë është analizuar një shembull i programit të monitorimit në Bashkinë Gjirokastrë, duke qenë se të gjitha programet dhe raportet e monitorimit të strehëzave ruajnë të njëjtën strukturë.

Referuar dokumentacionit në dispozicion situata paraqitet: Me kërkesë Nr. 343 Prot, datë 20.01.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë SHSSH ka hartuar një program-monitorimi për qendrën emergjente në Gjirokastrë, që ofron shërbime për viktimat e dhunës më bazë gjinore. Ky program ka synuar monitorimin e shërbimeve dhe aktivitetit ditor në një mënyrë tematike-financiare. Si bazë ligjore, programi referon Ligjin Nr.121/2016 dhe VKM Nr. 159/2019.

Pas analizës dhe vlerësimit, është konstatuar se programi duhet të pasurohet dhe të përfshijë edhe disa komponentë të tjera për të qenë sa më i plotë dhe në përputhje me standardet e

⁴⁵ <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Methodology-for-monitoring-and-evaluation-of-local-social-care-plan-implementation.pdf>

monitorimit⁴⁶. Përveç monitorimit financiar dhe tematik, është e rëndësishme të paraqiten në program edhe cilësia e shërbimeve, realizimi i objektivave, trajnimi i stafit, siguria dhe mbrojtja e të mbijetuarave, si dhe mekanizmat e feedback-ut nga ata. Kjo do të ndihmojë në një vlerësim më të plotë të shërbimeve të ofruara dhe do të garantojë një standard të lartë të shërbimit.

Për veç kësaj, ndërsa programi i hartuar është një fillim i mirë, është e nevojshme përputhshmëria e pasurimi dhe zgjerimin e tij me komponentët e mësipërm për një vlerësim më të plotë dhe efikas të shërbimeve të ofruara nga “qendrat e strehimit emergjent 72 orëshe” ose strehëzat.

Pas rishqyrtimit të raportit të monitorimit dhe krahasimit me programin e monitorimit të përcaktuar më herët duket se shumica e elementeve të programit janë trajtuar dhe janë brenda raportit. Raporti tregon se kushtet në qendër janë të mira dhe përputhen me tipologjinë e shërbimit, qendra funksionon 72 orë dhe pranon ata që kanë nevojë, aktivitetet janë të organizuara sipas një plani, ka një seksion për monitorimin financiar që flet për fondet dhe si janë shpenzuar ato dhe përshkrimi i qendrës është i detajuar, si dhe tregon se asnjë e mbijetuar e dhunës në familje nuk ka qëndruar në qendër për 72 ore.

Referuar metodologjisë, një monitorim më i thelluar është i domosdoshëm edhe për faktin që bashkitë kanë aplikuar me projekte për ngritjen e strehëzave për të mbijetuarat e dhunës në familje pranë MSHMS-së. Në projekte janë përcaktuar objektiva dhe tregues për tu arritur. Atëherë monitorimi i tyre nga SHSSH ka nevojë për një këndvështrim tjetër atë të arritjes së objektivave. Monitorimi i arritjes së objektivave është esencial për të verifikuar efektivitetin e qendrës në përmbushjen e detyrave të saj të parapara. Kjo përfshin jo vetëm numrin e të mbijetuarave që janë ndihmuar, por edhe ofrimin e trajnimeve ose shërbimet e tjera që janë përcaktuar në projekt. Nga ana tjetër, treguesit e performancës, si numri i personave të ndihmuar ose përqindja e atyre që kanë marrë trajnime këshillime, shërbime shëndetësorë, juridike etj, duhet të vlerësohen për të siguruar se janë në përputhje me parametrat e përcaktuar të projektit.

Një tjetër komponent kritik është efektiviteti i shpenzimeve, ku duhet të bëhet një krahasim midis fondit të shpenzuar dhe rezultateve të arritura. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e çdo mospërputhjeje dhe do të sigurojë se fondet janë përdorur në mënyrë të efektive. Përveç kësaj, një vështrim mbi vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e qendrës është thelbësor. Është e rëndësishme të identifikohet nëse janë marrë masat e duhura për të garantuar funksionimin e qendrës edhe pas përfundimit të fondit të projektit dhe cilat janë planet afatgjata të bashkisë për të.

Përfundimisht, të dhënat dhe vlerësimet nga përfituesit e shërbimeve të qendrës megjithëse janë një burim i çmuar informacioni janë formale dhe të thjeshta, jo në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe me projektet e miratuara.

Monitorimi pro aktiv e raportimi i të dhënave, nëpërmjet sistemit SSHKSH të regjistrimit të shërbimeve shoqërore për rastet e dhunës në familje nuk është efektiv.

Në vitin 2018 është ngritur dhe funksionon Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SSHKSH) ka për qëllim ndërtimin e një mekanizmi funksional për referimin, ndjekjen, monitorimin dhe vlerësimin e rasteve për përkujdesje shoqërore për disa kategori sociale, ndër to edhe të mbijetuarat e dhunës në familje. Ai gjithashtu ndihmon në identifikimin e rasteve, këshillimin dhe hartimin e planeve individuale të përkujdesjes nga njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimin e rastit, sipas ligjit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Kjo platformë elektronike favorizon referimin në shërbimet specifike sociale, qoftë në nivel vendor, rajonal ose kombëtar. Një tjetër funksion është lehtësimi i komunikimit dhe

⁴⁶ <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Methodology-for-monitoring-and-evaluation-of-local-social-care-plan-implementation.pdf>

bashkëpunimit me regjistrat e tjerë elektronikë, si dhe unifikimi dhe kompjuterizimi i të dhënave të rasteve për të përmirësuar cilësinë e statistikave të harmonizuara që prodhohen nga sistemi⁴⁷.

Shërbimi Social Shtetëror është institucioni që ka përgjegjësinë për administrimin dhe përditësimin e kësaj baze të të dhënave. Si administrues, ai garanton se të dhënat janë të sakta, të përditësuara dhe të siguruar. Kjo do të thotë se çdo informacion që shtohet, modifikohet ose hiqet nga regjistri reflekton një realitet të saktë dhe aktual të situatës së përdoruesve të kujdesit shoqëror. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që vendimet dhe ndërhyrjet që bëhen në fushën e kujdesit shoqëror të jenë sa më efikase dhe të përshtatshme.

Sistemi SHKSH është operativ dhe i qasshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, DRSHSSH, qendrat e kujdesit dhe të tjerë për të ofruar dhe koordinuar shërbime për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe grupet e tjera sociale. Sistemi është i lidhur me një sërë sistemesh të informacionit, si: Regjistri i Gjendjes Civile, QKB, Drejtoria e Tatimeve, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe të tjerë, për të siguruar të dhëna të plota dhe të sakta për ata që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Kjo lidhje me sisteme të ndryshme siguron një koordinim të fortë dhe një pamje të plotë të situatave, duke mundësuar shërbime më efikase dhe të personalizuar për nevojat e individëve dhe familjeve.

Sistemi SSHKSH nuk ndër vepron me sistemin REVALB si një sistem i rëndësishëm posaçërisht për menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje. Nga rishqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion, intervistat, dhe pyetësorët me specialistë të të gjitha niveleve në SHSSH, mbi funksionimin e tij në lidhje me monitorimin dhe raportimin e të dhënave, nivelin e përdorimit përditësimin të tij, për rastet e të mbijetuarave të dhunës në familje për periudhën 2020-2023 u konstatua se, sistemi SSHKSH ishte operativ por nuk përdorej:

Nga një analizë e thjeshtë e ecursisë së nivelit të përditësimin si numër bashkish të sistemit në vite rezultoi se, viti me përqindje më të ulët të përdorimit të sistemit për periudhën e auditimit ka qenë 2021, me vetëm 5 bashki nga 61 gjithsej ose 8% të totalit të bashkive në vend. Ndërsa vitin me përqindje më të lartë të përdorimit ka qenë 2020, ku përditësojnë sistemin 11 bashki nga 61 gjithsej ose 18% e totalit të bashkive në vend. Ose thënë ndryshe rreth 50 bashki nuk përditësojnë të dhëna në sistem, ky ndryshim i ndjeshëm në përdorim tregon për një situatë tejet kritike dhe nevojën për përmirësime në përdorimin e sistemit të shërbimeve shoqërore. Përdorimi i ulët i këtij sistemi tregon për një ulje të efektivitetit të tij në lidhje me monitorimin dhe raportimin e të dhënave, duke u pasuar dhe me ulje të nivelit dhe cilësisë së shërbimeve.

Tabela nr.11 Shkalla e përdorimit të sistemit SSHKSH

Vitet	Nga 61 gjithsej, Nr i Bashkive që kanë hedhur të dhëna në SSHKSH, për DHF	Numri i rasteve të hedhura në SSHKSH, për DHF, Burimi SHSSH dhe DPPSH	Rastet e DHF të evidentuara nga Policia e Shtetit
2020	11 ose 18% ⁴⁸	87 ose 1.8% ⁴⁹	4701
2021	5 ose 8%	30 ose 0.5 %	5312
2022	8 ose 13 %	38 ose 0.7%	5210

⁴⁷ Vendim nr. 136, datë 7.3.2018 për funksionimin dhe administrimin e regjistrat elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

⁴⁸ 11*100/61 Numri i bashkive që kanë hedhur të dhëna në SSHKSH*100/ Numrin e Bashkive gjithsej.

⁴⁹ 87*100/4701 Numri i rasteve të hedhura në SSHKSH*100/ Numri i rasteve të evidentuara nga Policia e Shtetit

2023	5 ose 8%	43 ose 1.1 %	3829
------	----------	--------------	------

Burimi SHSSH dhe DPPSH, përpunoi grupi i auditimit

Në një analizë të mëtejshme, duke përfshirë aspektin e numrit të rasteve të evidentuara nga Policia e Shtetit dhe të rasteve të hedhura në sistemin e administruar nga SHSSH, grupi i auditimit konstatoi se:

Niveli më i lartë i përditësimit të sistemit të SHKSH për trajtimin e rasteve të evidentuara nga Policia e Shtetit është regjistruar në vitin 2020 me 87 raste nga 4701 gjithsej ose 1.8% të rasteve, ndërsa niveli më i ulët është vërejtur në vitin 2021 me vetëm 30 raste nga 5312 gjithsej ose 0.5% të rasteve janë trajtuar në sistemin SSHKSH. Supozohej se pas 4 vitesh nga viti 2020 deri më sot, përdorimi i këtij mekanizmi dixhital menaxhimi dhe monitorimi do të ishte shumë më i lartë, por rezultati aktual tregon një përdorim minimal të kësaj infrastrukture dixhitale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje me shërbime shoqërore.

Gjatë kësaj periudhe kohore, janë krijuar 1600 llogari për përdorues, megjithatë, është vërejtur që shumica e përdoruesve nuk kanë kryer një përditësim sistematik të këtij sistemi

Sa më lartë shifrat flasin për një situatë kritike të mos përdorimit të këtij sistemi, e për një ndarje të dukshme midis potencialit të sistemit dhe përdorimit të tij efektiv.

Nga ana tjetër nuk janë realizuar auditime dhe monitorime të sistemit SSHKSH, nga SHSSH dhe MSHMS, si rrjedhojë mungojnë dokumentet e ndjekjes dhe shqyrtimit të sistemit dhe situatës kritike ku ndodhet, detaje që do të ofronin një panoramë të trajtimit të problematikave të identifikuar të platformës dhe marrjen e masave për përmirësimin e saj. S'ka një regjistrim të pakënaqësive nga përdoruesit e sistemit, duke penguar një shqyrtim të hollësishëm të ndërveprimit të tyre me platformën dhe incidenteve që kanë përjetuar. Ka munguar shqyrtimi i raporteve periodike nga aplikacioni nga struktura e monitorimit në SHSSH, të cilat janë esenciale për të kuptuar dinamikën e funksionimit të aplikacionit me kalimin e kohës. Po ashtu, s'janë mbajtur mbledhje me minuta-takime për analizimin e gjendjes dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e përditësimit të sistemit, duke mos informuar vendimmarrësit. Këto janë disa nga aspektet që kanë ndikuar në mos përdorimin e platformës SSHKSH gjatë viteve nga autoritetet lokale për rastet e dhunës në familje.

1- Gjetje nga auditimi: Në strategjinë për Barazinë Gjinore 2021 - 2030 është vendosur si objektiv “Fuqizimi i sistemit REVALB dhe përdoruesve/përdoruesve të tij”. Nga auditimi u konstatua se, përdorimi i sistemit REVALB për evidentimin e monitorimin rasteve të të mbijetuarave të dhunës në familje është dobësuar, ku në dy vitet e fundit ra nga 65% në 51% dhe 31% të numrit të bashkive gjithsej që identifikojnë në sistem rastet e dhunës në familje.

2- Gjetje nga auditimi: Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqërore (SSHKSH) duhet të përditësohet me të gjitha rastet e dhunës në familje. Nga auditimi dhe analiza e situatës u konstatua se, përdorimi i tij për trajtimin dhe monitorimin e rasteve të shërbimeve shoqërore për të mbijetuarat e dhunës në familje është në nivele shumë të ulëta mes 0.5 deri 1.8%. Ndërsa këto raste janë përditësuar në SSHKSH nga 8 - 18% e bashkive.

1. Konkluzioni: Përdorimi i pakënaqshëm, koordinimi e monitorimi i mangët i sistemeve të informacionit REVALB dhe SSHKSH nga Bashkitë dhe institucionet përgjegjëse, si MSHMS dhe SHSSH, ka çuar në një zvogëlim të efektivitetit të tyre. Kjo ka ndikuar negativisht në interesin për përdorimin e këtyre sistemeve dhe në aftësinë për monitorimin e duhur të rasteve të dhunës në familje e shërbimeve shoqërore ndaj tyre. Si rezultat, potenciali i teknologjisë së informacionit për të ndihmuar në menaxhimin e dhunës në familje e shërbimeve shoqërore ndaj tyre, nuk po shfrytëzohet siç duhet, duke sjellë mungesë të regjistrimit e rasteve të dhunës e të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje, mungesë monitorimi e transparence dhe sfida në vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë plan veprimi me masa e afate konkrete për përdorimin e sistemit Regjistrimi i Dhunës në Familje (REVALB) nga të gjitha Bashkitë, si dhe përditësimin e hedhjes së të dhënave të prapambetura nga viti 2021 në sistem.

Brenda datës 31.12.2024

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të hartojë plan veprimi me masa e afate konkrete për përdorimin e Sistemit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SSHKSH) dhe monitorimin nëpërmjet tij të situatës së shërbimeve shoqërore për të mbijetuarat e dhunës në familje në vend.

Brenda datës 30.06.2024

3- Gjetje nga auditimi: Bashkitë dhe elementët përbërës të Mekanizmit të Koordinimit të Referimit janë të detyruara për monitorimin dhe raportimin e dhunës në familje. Nga auditimi u konstatua se në programet e monitorimit ose të auditimit në bashki kanë munguar aspekte të monitorimit të dhunës në familje. Gjithashtu kanë munguar, raportimi periodik tremujor, komunikim i përshtatshëm ndërinstitutional dhe aktualizimi i të dhënave në sistemin REVALB në Bashki.

2. Konkluzioni: Mungesa e përdorimit efektiv të instrumenteve dhe procedurave të përcaktuara për monitorimin dhe raportimin e DHF në Bashki, rezulton negativisht në aftësinë e institucioneve për të monitoruar dhe menaxhuar rastet e dhunës në familje në nivel lokal. Gjithashtu, mos raportimi dhe mungesa e komunikimit ndërinstitutional në nivel lokal mund të çojnë në humbjen e informacionit të rëndësishëm dhe në një koordinim të pamjaftueshëm për të ofruar mbështetjen e nevojshme për viktimat e DHF.

3.1 Rekomandimi: Bashkitë Durrës Kukës dhe Gjirokastrë të hartojnë programe monitorimi ose auditimi mbi baze vjetore për monitorimin e aktivitetit të mekanizmit të koordinimit të referimit dhe të marrin masa për raportimin çdo tre muaj nga komiteti drejtues drejt MSHMS.

Menjëherë dhe në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Monitorimet e kryera nga Shërbimit Social Shtetëror duhet të kryhen në përputhje me metodologjinë e monitorimit të shërbimeve shoqërore. Nga auditimi është konstatuar se programet e monitorimit dhe më pas raportet janë formale, ato hartohen duke u fokusuar kryesisht në aspektin tematik - financiar të monitorimit të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje.

3. Konkluzioni: Mungesa e një përdorimi efektiv të metodologjisë së përshtatshme të monitorimit të shërbimeve shoqërore për dhunën në familje nga Shërbimi Social Shtetërorë, rezulton në zhvillimin e monitorimeve formale dhe të përqendruara kryesisht në aspektin tematik-financiar, duke neglizhuar elementët e tjerë të vlerësimit të shërbimeve.

4.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror të rishikojë planet dhe programet e monitorimit, me qëllim që ato të jenë të detajuara për të garantuar përdorimin e duhur të fondeve kundrejt objektivave e rezultateve të projekteve sociale (strehëza) dhe mënyrën e realizimit të shërbimit të specializuar për të mbijetuarat e dhunës në familje për rehabilitimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.3 Pyetje e auditimit: A janë përdorur kapacitetet njerëzore dhe financiare, etj, në mbështetje të sistemit ?

Shteti nëpërmjet mekanizmave të krijuar dhe një sistemi rregullash ligjore duhet të garantojë në mënyrë të mjaftueshme mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarit. Në këtë kontekst, ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat të cilët janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë ka një rol të rëndësishëm për mbështetjen, respektimin e të drejtave të njeriut dhe trajtimin me dinjitet të tij. Referuar të dhënave të institucioneve objekt i këtij auditimi, gjatë viteve 2020-2022 në institucionet e vendit janë regjistruar mesatarisht rreth 5,000 raste/vit të dhunës në familje. Ndërkohë numri në fakt mund të jetë edhe më i lartë, pasi një numër i konsiderueshëm rastesh këshillohet dhe suportohet nga organizatat jo-fitimprurëse të cilat kanë në mision të tyre ndihmën ndaj grave, viktimave të dhunës në familje, por nuk përjashtohen edhe rastet të cilat për shkaqe të ndryshme, formimi kulturor, arsimor, traditat e vendit ku jetojnë, apo dhe të tjera, mund të mos bëhen pjesë e evidencave shtetërore në rastet kur nuk e raportojnë dhunën duke e denoncuar atë.

Aktualisht vendi disponon një kuadër ligjor i cili përfshin masat e koordinuara⁵⁰ midis institucioneve ndaj dhunës në familje si në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të saj por edhe për garantimin e mbrojtjes me masa të nevojshme për viktimën. Gjithashtu, ky kuadër rregullon dhe sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror⁵¹ që gratë, viktimave të dhunës në familje të përfitojnë, ku përmendim, shërbimet shoqërore në raste emergjence, shërbimet për strehim në qendra rezidenciale dhe strehëza, rezidenciale, etj. Në të janë përcaktuar edhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse si për institucionet e pushtetit qendror por gjithashtu edhe për organet e vetëqeverisjes vendore, këshillat e qarkut dhe bashkitë vendit. Më poshtë evidentohet situata për përfituesit për viktimat e dhunës, masa e mbështetjes shtetërore për ta, mënyrat e financimit të institucioneve përgjegjëse, kapacitetet e disponueshme etj.

Mënyra e financimit të shërbimeve për dhunën në familje

Financimet në mbështetje të grave, viktimave të dhunës në familje përfshihen brenda programeve apo produkteve buxhetore të institucioneve të cilët lidhen në aktivitetin e tyre mbulojnë një fushë përgjegjësie të caktuar apo marrin masat që lidhen me dhunën në këtë drejtim ndaj ato nuk gjenden si zë më vete në treguesit buxhetor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është autoriteti kryesor përgjegjës në rrjetin e koordinuar të institucioneve përgjegjëse për mbrojtje, parandalimin, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave dhe lehtësimin e pasojave. MSHMS financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet programit buxhetor 10430 “Përkujdesi Social”. Ky program mbështet nëpërmjet pagesave për shërbimet sociale dhe përfshirjen e barabartë sociale dhe ekonomike të burrave, grave, fëmijëve dhe grupeve të marginalizuara. Fondet për përkujdesin shoqëror për gratë e dhunuara, janë pjesë në dy produkteve kryesore buxhetore të kësaj ministrie.

- kodi 91307AC “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike” dhe

⁵⁰ Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar

⁵¹ Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

- kodi 91307AH “Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social”.

Fondet e përkujdesit social (trajtuar në pikën 3.4 Pësja në buxhet) përfshijnë fondet për Shërbimin Social Shtetëror institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe institucione në varësi të saj që ofrojnë shërbime të përkujdesit dhe konkretisht QKTVDHF.

Shërbimin Social Shtetëror si institucion monitorues edhe kontrollues për standardet dhe financimet në ofrues të tjerë shërbimesh për viktimat e dhunës në familje ka një sferë më të gjerë veprimi në shërbimet sociale.

Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje si institucion varësie është institucioni i vetëm shtetëror në nivel kombëtar që kryen shërbim të drejtpërdrejtë dhe të dedikuar për gratë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo qendër është subjekt buxhetor dhe si e tillë ndjek disiplinën buxhetore të parashikuar.

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk kanë struktura të dedikuara për këtë qëllim e për rrjedhojë dhe fondet pasqyrojnë të gjithë veprimtarinë e institucionit.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet që rregullisht të programojnë fonde, të angazhojnë struktura të specializuara të shërbimit social, të ngrenë qendra emergjence për viktimat e dhunës në familje si dhe qendrave për rehabilitimin e tyre, ofrimin e shërbimeve për to, etj. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet një periudhë prej 2 vitesh për transferimin e qendrave rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Procesi i decentralizimit të shërbimeve nuk është realizuar ende megjithëse duhet të kishte përfunduar brenda vitit 2018. Aktualisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë ngritur strukturat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ndërkohë fondet e dedikuara nga bashkitë në mbështetje të viktimave dhe rehabilitimit të tyre janë të pakta.

Fondi Social si një mekanizëm mbështetës

Fondi Social⁵² është një mekanizëm financiar mbështetës nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale në territor. Ky fond krijohet, nga fondet e kushtëzuara të MSHMS, fondet e vetë NJVV-ve apo dhe të ardhurave nga OJF, individët dhe bizneset, donatorë si dhe tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve. Njësitë vendore vlerësojnë nevojat për shërbime shoqërore të nevojshme nëpërmjet Planeve Sociale Vendore të miratuar nga këshillat bashkiakë respektivë, si dhe në vlerësim të kapaciteteve buxhetore bëjnë aplikim në MSHMS për financim pas thirrjes që kjo e fundit bën çdo vit. Një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim kryen vlerësimin e tyre dhe përzgjedh projektet të cilat do të financohen nga ky fond referuar kritereve të përcaktuara⁵³. Financimi nga buxheti është në nivelin 90% të kostove për vitin e parë, 60% për vitin e dytë dhe 30% për vitet në vijim. Fondet kalojnë NJVV-ve nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror i cili kryen edhe kontrollin e standardeve dhe përdorimit të tyre në vijim.

Nëpërmjet Fondit Social buxheti i shtetit financon disa lloj shërbimesh shoqërore mes të cilave edhe shërbime të cilat lidhen me gratë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare. Pavarësisht

⁵² VKM nr. 112 datë 23.02.2018, “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”

⁵³ VKM nr. 150 datë 20.03.2019, “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”

detyrimin për raportim periodik çdo 4 muaj nga ana e bashkive nuk rezulton që ky raportim të jetë i vijueshëm.

Veç mbështetjes të projekteve të bashkive me bashkëfinancim nëpërmjet Fondit Social parashikohet mbështetje edhe për disa shërbime të specializuara ndihmëse të ofruara në nivel qarku, si edhe linjat kombëtare të këshillimit telefonik që kanë marrëveshje bashkëpunimi/kontratë me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale. Këto të fundit nuk i nënshtrohen financimit të përcaktuar 3+ vite sikundër projektet e bashkive. Nga të dhënat e disponuara gjatë auditimit evidentohet se, nëpërmjet Fondit Social financohet edhe L.... e K..... për G.... dhe V.... (L....) projekt i paraqitur çdo vit nëpërmjet Këshillit të Qarkut Tiranë. Sipas të dhënave kjo linjë pavarësisht se aplikon nëpërmjet njësisë së vetëqeverisjes ofron shërbime në nivel kombëtar e si e tillë rregullisht sipas VKM nr. 150 datë 20.03.2019, “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, duhet të kishte një kontratë të lidhur me MSHMS për ofrimin e shërbimit. Referuar këtij vendimi, MSHMS duhet të dispononte vendimet e Këshillit të Qarkut lidhur me miratimin e shërbimeve që duhet të ofrohen në territorin e tij pas hartimit të planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të bashkive dhe të miratuar nga këshilli i qarkut, çka është një kusht paraprak përpara shqyrtimit të kërkesës. Nuk evidentohet vijueshmëri e raportimeve nga Këshilli i Qarkut drejt SSHS, MSHMS.

Më poshtë paraqiten të dhënat e Fondit Social sipas viteve dhe vlerat e financimit për viktimat e dhunës në familje.

Tabela nr. 12 Treguesit vjetorë për Fondin Social


Në lekë

VITI	Fondi Social	Fondi i dedikuar për qendra/strehëza që lidhen me dhunën në familje	Pjesëmarrja në % e dhunës në familje
2020	94,481,000	30,639,489	32%
2021	147,894,616	38,004,723	26%
2022	158,818,000	34,793,036	22%
2023	145,110,817	32,482,835	22%
Gjithsej	401,193,616	135,920,083	34%

Burimi: MSHMS, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Fondet të cilat në kuadër të Fondit Social janë dedikuar për dhunën në familje zënë 1/3 e vlerës totale të tij. Me këtë vlerë janë financuar 6 projekte nga të cilat 3 OJF nga të cilat 2 prej tyre të ndodhura në Tiranë dhe Vlorë, ofrojnë shërbime për disa problematika sociale si dhe një linjë e cila ofron këshillim në nivel kombëtar për gratë dhe vajzat e dhunuara me qendër në Tiranë. Ndërsa 3 qendra emergjente polivalente, në nivel bashkie të financuara ofrojnë disa lloj shërbimesh ku përfshihen edhe raste të dhunës në familje. Më poshtë paraqitet financimi sipas llojit OJF/Institucion Shtetëror.

Grafik nr. 6 Financimet nga Fondi Social drejt institucioneve shtetërore dhe OJF



Sa më sipër evidentohet se, shumica e fondeve dhe rrjedhimisht e shërbimeve në mbështetje për viktimat e dhunës i kalon organizatave jofitimprurëse dhe vetëm rreth 20% të fondeve kalon nëpërmjet bashkive. Thëksojmë se fondet e paraqitura më sipër për qendrat multifunktionale të hapura në Bashkinë Kukës, Gjirokastrë dhe Berat, vlerat e akorduara për to janë përfshirë të plota për temën nën auditim pasi nuk mund të bëhej një ndarje për kostot e trajtimit vetëm të viktimave të dhunës. Megjithatë vendi paraqitet me një numër të lartë denoncimesh për dhunën në familje numri i qendrave, infrastruktura e tyre si dhe stafet e tyre paraqiten të pamjaftueshme për mbulimin e nevojave.

Ndihma ekonomike e përfituar nga viktimat e dhunës në familje

Viktimat e Dhunës në Familje që nuk trajtohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, përfitojnë ndihmë ekonomike nga shteti, referuar VKM-në nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, e ndryshuar. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës. Masa e kësaj ndihme është ndryshuar gjatë viteve të fundit dhe paraqitet si më poshtë:


Figura nr. 7 Ndhimja ekonomike në vite për dhunën në familje



Sa më sipër, vlera e ndihmës ekonomike në vitin 2020 ka qenë e përcaktuar 3,000 lekë/muaj. Si rrjedhojë e disa ndryshimeve në VKM nr.597, datë 04.09.2019 mbi masat të marra gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, vlera e ndihmës ekonomike ka pësuar rritje në varësi të plotësimit të disa kriterëve të vendosura në këto ndryshime. Më tej vlera e saj është fiksuar në 9,000 lekë/muaj në vitin 2022 dhe prej muajit Tetor 2022 ajo gjendet në vlerën prej 9,900 lekë/muaj.

Ndërkohë që numri i përfituesve të kësaj ndihme paraqitet si më poshtë vijon:

Figura nr.8 Numri i përfituesve të NE



Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që rezultojnë të pajisur me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje, kanë të drejtë të aplikojnë pranë seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në Njësitë Vendore nga data 1-10 të çdo muaji, për të përfituar ndihmë ekonomike. Sa vihet re numri i përfituesve ka rritje. Mesatarisht 1/5 e viktimave të dhunës kanë përfituar ndihmë ekonomike ndërsa raporti shkon në 1/3 e numrit të cilët kërkojnë urdhër mbrojtje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtje.

Bonusi i qerasë

Veç mbështetjes me pagesa mbi urdhrat të mbrojtjes nga gjykata, viktimat e dhunës asistohen edhe me bonus qiraje nga bashkitë e vendit pas miratimit të kërkesave në Këshillin Bashkiak.

Në disa raste bonusi i qirasë paguhet edhe nga OJF të cilat mbështesin këtë kategori. Grupi i auditimit kërkoi një informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si autoriteti kryesor për koordinimin e institucioneve për numrin e përfituesve në rang vendi të bonusit të qirasë për gratë dhe gratë me fëmijë, viktimat të dhunës në familje, por as MSHMS dhe as Shërbimi Social Shtetëror nuk e dispononte këtë të dhënë. Nëse të dy sistemet informatike REVALB dhe SSHKSH do të përdoreshin dhe populloheshin rregullisht kjo e dhënë e cila është element i rëndësishëm për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, mund të evidentohet në çdo kohë. Më poshtë paraqiten treguesit e bonusit të qirasë për Bashkitë, Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë, të cilat ishin subjekte të këtij auditimi, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 13 Përfitues të bonusit të qirasë sipas viteve në tre bashkitë e audituara

VITI	Përfitues Bonusi Qiraje në Durrës		Përfitues Bonusi Qiraje në Kukës		Përfitues Bonusi Qiraje në Gjirokastrë	
	Bashkia	OJF	Bashkia	OJF	Bashkia	OJF
2020	1		0		0	
2021	3		0		2	1
2022	5		0	3	3	
01-06/2023			0	5	2	
Gjithsej përfitues	9	0	0	8	7	1
Vlera e përfitimit /në Lekë	760,000	0	0	390,000	779,000	45,000


Burimi: Bashkitë, Kukës, Durrës, Gjirokastrë përpunuar nga Grupi i Auditimit

Vlera mujore të akorduara nga Bashkia Kukës janë 25,000 dhe 30,000 lekë/muaj sipas tipit të apartamentit. Bashkia Durrës akordon bonus 50% të vlerës së vlerës së qirasë të përcaktuara sipas strukturës së apartamentit e vlerësuar 20,000/25,000/30,000 lekë.

Bashkia Gjirokastrë financoon pjesërisht bonusin e qirasë ndërsa pjesa tjetër paguhet si mbështetje buxhetore nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë vlerat e qirasë janë 8,000/13,000/16,500/22,000 lekë në varësi të tipit të apartamentit. Për sa më sipër, mbështetja e viktimave të dhunës me bonus qiraje nga 3 bashkitë e audituara mungon tërësisht ose është mjaft e ulët. Nga intervistat e zhvilluara në terren evidentohet se, procesi i miratimit të bonusit të qirasë nga Këshilli Bashkiak kërkon kohë, çka bën ndikon që viktimat e dhunës të gjenden përballë shpenzimesh për përmbushjen e nevojave të strehimit.

Strehimi me banesë sociale apo financim për marrjen e një të tille mbetet një problematikë e evidente. Në tre bashkitë subjekte të këtij auditimi për periudhën 3.5 vjeçare, vitet 2020-2023/06 situata e strehimit me shtëpi apo kundrejt ofrimit të mbështetjes financiare paraqitet si vijon:

Figura nr. 9 Përfitues strehimi social



Të dhënat e mësipërme në vetëm tre bashki tregojnë një shkallë mbështetje të ulët të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim të këtyre rasteve, çka evidenton nevojën për një vlerësim të thelluar të situatës në nivel kombëtar nga ana e MSHMS në rolin e autoritetit kryesor përgjegjës për nxjerrjen e konkluzioneve të plota mbi bazën e të cilave të hartohen politika të mbështetura dhe efektive në këtë drejtim.

Kapacitetet e disponueshme në rang kombëtar

Referuar të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror, mbi kapacitetet institucionale në vend, për akomodimin e grave apo grave me fëmijë, viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, rezultoi se në vend funksionojnë në total 6 strehëza/qendra nga të cilat:

- 1 Qendër Rezidenciale Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës;
- 5 Strehëza emergjence multifunksionale.

- Qendra Kombëtare e Trajtitit të Viktimave të Dhunës në Familje me vendndodhje në Bashkinë Kamzë është institucion i dedikuar për akomodimin e grave viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ndërkohë në tre qendrat multifunksionale të ngritura në kuadër të Fondit Social, qendra e ndërtuar në Bashkinë, Gjirokastrë është multifunksionale, pra nuk është qendër e dedikuara për rastet e grave/gravave me fëmijë viktimave të dhunës në familje, të cilat kërkojnë dhe një trajtim të diferencuar edhe ambiente të veçanta dhe me një nivel të caktuar sigurie, por në të trajtohen edhe individë me problematika të ndryshme sociale pavarësisht gjinisë së tyre.

Ndërkohë qendra e ngritur në Bashkinë Berat ka si objekt përfitimin e shërbimeve nga fëmijët 0-18 vjeç, gra dhe vajza të dhunuara, si dhe të mitur viktimave të dhunës në familje. Në këtë rast kemi akomodim dhe trajtim të fëmijëve në të njëjtin ambient me gratë e dhunuara. Edhe qendra e emergjencës e ngritur në Bashkinë Kukës ka si objekt shërbimet jo vetëm për gratë dhe vajzat e dhunuara, por edhe për gratë e divorcuara, ato me probleme sociale ekonomike, si dhe gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat rurale. Më poshtë paraqiten të dhënat mbi kapacitetet akomoduese nga institucionet shtetërore në rang kombëtar.


Tabela nr. 14 Kapacitetet kombëtare për akomodim të grave, viktimave të dhunës në familje

Nr.	Bashkia ku ndodhet strehëza/qendra	Emri i Strehëzës/qendrës	Emergjence multifunksionale Nr. shtretërisht	Emergjence e dedikuar për DHF Nr. Shtretërisht	Qendër Rezidenciale DHF/ Nr. shtretërisht	E licencuar për ofrim shërbimesh ?
1	KAMZË	Qendra Kombëtare e Trajtitit të Viktimave të Dhunës në Familje			32	Nuk ka/ Në proces
2	Berat	Strehëza e emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara	4			Nuk ka
3	Gjirokastrë	Qendra emergjente polivalente	17			Nuk ka
4	Kukës	Shërbim emergjent 72 orë për viktimat e dhunës në familje	2			Nuk ka
5	Durrës	Qendër multifunksionale emergjence	5			Nuk ka
6	Rroksvec	Strehëza Gratë e Dhunuara	2			N/a
GJITHSEJ			30	0	32	

Burimi: SSHS, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Aktualisht kapacitetet kombëtare shtetërore për strehimin e grave, viktimave të dhunës në familje janë të limituara. Gjenden gjithsej rreth 30 shtretër në nivel kombëtar për strehim emergjent, por edhe këto kapacitete nuk janë të plota duke qenë se qendrat e mësipërme janë multifunksionale dhe pranojnë një gamë më të gjerë njerëzish në nevojë. Ndërkohë për akomodimin afatgjatë të grave të dhunuara dhe atyre me fëmijë, janë vetëm 32 shtretër në rang kombëtar.

Figura nr. 10 Rastet e dhunës në familje dhe kapacitetet shtetërore



Ndërkohë që, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror pavarësisht numrit të lartë të viktimave të dhunës në familje, nuk kanë bërë ende një vlerësim të kapaciteteve të nevojshme për këtë qëllim.

Një numër i caktuar shërbimesh të përkujdesit shoqëror për gratë dhe vajzat viktimave të dhunës në familje ofrohet edhe nga disa OJF të cilat operojnë në këtë drejtim dhe janë një mbështetje në situatën e kapaciteteve të pakta nga ana e institucioneve të vendit, përfshirë këtu institucionet qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore.

Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka të përcaktuar rastet kur i dhunuari dhe dhunuesi ndodhen në të njëjtën banesë, ai detyrohet të largohet nga banesa. Referuar këtyre dispozitave i dhunuar gjithashtu duhet të detyrohet nga gjykata të marrë pjesë edhe në procese rehabilituese në qendra të specializuara. Ky detyrim duhet të përcaktohet në vendimet e dala nga gjykatat për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat e mbrojtjes. Megjithatë evidentohet se kjo dispozitë e cila gjendet në diskrecionin e gjykatave nuk aplikohet gjerësisht. Ndërkohë ende nuk ka një kuadër të rregullator të përcaktuar se çfarë duhet bërë për akomodimin e dhunuesit pas daljes nga banesa, çka është një problematikë aktuale e evidentuar edhe nga grupet e shoqërisë civile pasi në shumë raste në mungesë të strehimit alternativ apo vlerave financiare, dhunuesit kthehen sërish pranë banesës së tyre, çka krijon pasiguri për viktimën.

Infrastruktura e strukturave akomoduese

Grupi i auditimit vëzhgoi në terren disa qendra akomodimi të grave, objekt i dhunës në familje, përkatësisht në Kamzë, Kukës, Gjirokastrë dhe Durrës. Ambientet e këtyre qendrave kishin infrastrukturë modeste ku paraqitej nevoja për mirëmbajtje, riparim dhe përmirësim. Privatësia dhe ruajtja e konfidencialitetit të rastit në qendrat e vizituara, veç qendrës kombëtare në Kamzë, nuk garantohej pasi ambientet ishin multifunksionale, pra dhe për natyra të tjera problematikash sociale, grup moshash të ndryshme etj. Në vijim paraqesim disa foto nga vizitat e zhvilluara.

Foto nr. 1 Ambiente nga Qendra në Gjirokastrë
Burimi: Grupi i auditimit



Në qendrën multifunkionale në qytetin e Gjirokastrës paraqiteshin problematika në godinë si rrjedhojë e lagështisë si dhe dhomat kishin një numër i lartë shtretërish. Ndërkohë ambientet e kuzhinës së improvizuar gjendeshin të pamjaftueshme për të garantuar ushqimin ditor.

Foto nr.2 Qendra e Emergjencës në Kukës
Burimi: Grupi i auditimit





Qendra e Emergjencës në Kukës ndodhej brenda ambienteve të zyrave të bashkisë dhe ishte e përbërë nga dy dhoma njëra nga të cilat vetëm njëra shërbente për akomodim. Në ambient kishte probleme lagështie nga tarraca, duke qenë në katin e fundit të ndërtesës. Pozicionimi i saj brenda ambienteve të zyrave të bashkisë nuk garantonte privatësinë e trajtimit të rastit dhe si e tillë kjo gjë mund të krijoj kufizime në akomodimin e rasteve.

Në Qendrën Rezidenciale Kombëtare në Kamzë, problematikat evidentoheshin kryesisht në riparime dhe arredimet e dhomave me gjërat e nevojshme për një jetesë normale. Qendrat e vizituara rezultonin me mungesa në dokumentacionin e pronësisë së ambienteve çka krijon pengesa për kryerjen e riparimeve dhe rikonstruksioneve për sjelljen e tyre në formë të përshtatshme për banim dhe më tej licencimin e shërbimit që ofrohet prej tyre.

Licencimi i qendrave që ofrojnë akomodim dhe shërbime shoqërore

Qendrat e trajtuara më sipër nuk rezultojnë të licencuara në QKB për ofrimin e shërbimeve të kujdesit komunitar dhe rezidencial. Licencimi është një detyrim ligjor për ofruesit e shërbimeve të “Përkujdesit Shoqëror” referuar nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, në të cilin “Shërbimet Komunitare” dhe “Shërbimet Rezidenciale” bëjnë pjesë në kategorinë e shërbimeve për të cilat licencimi bazohet edhe në kryerjen e një procesi inspektimi në vend, kjo referuar nenit 16 të tij. Të dyja veprimtaritë bëjnë pjesë në kategoritë X.1 të shtojcës së ligjit dhe X.1.B të VKM nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB”.

Licenca a) "shërbime të përkujdesit komunitar" me kodin X.1.A i përket grupit të dytë dhe licencohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit

Licenca b) “shërbime të përkujdesit rezidencial” me kodin X.1.B 3. i përket grupit të tretë dhe licencohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Subjektet aplikojnë on-line. Dokumentacioni nëpërmjet sistemit nga QKB dërgohet në MSHMS, e cila shqyrton dokumentacionin nëse është konform kriterëve dhe ia përcjell Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili bën inspektimin, vlerësimin faktik në vend.

Mbi strukturat e MSHMS dhe MD

-Në MSHMS struktura përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe të adresimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, është Drejtoria e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore / Sektori i Politikave të Barazisë Gjinore.

Me ri-organizimin e ministrive ndodhur në Tetor 2017, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) u bashkua me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe u krijua Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ristrukturimi krijoi Sektorin e Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore me përbërje (1+4) 1 përgjegjës dhe 4 specialist.

Ky sektor ishte pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në ri-organizimin e fundit të MSHMS sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 121, datë 28.10.2021 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Sektori i Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, merr emërtesën Sektori i Barazisë Gjinore me përbërje (1+2) 1 përgjegjës dhe 2 specialist. Misioni i kësaj strukture është: Hartimi, zhvillimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave dhe strategjive/planeve kombëtare për barazinë gjinore në shoqëri si dhe adresimi i çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Gjatë periudhës nën auditim ky sektor është shoqëruar nga vakanca në pozicionet e punës dhe reduktimi i numrit të punonjësve ka ndikuar në miradministrimin e veprimtarive të përmendura gjatë auditimit. Numri i konsiderueshëm i rasteve të dhunës në familje si dhe problematikat e evidentuara mbi sistemin aktual, evidentojnë nevojën për rishikimin e këtij sektori brenda burimeve ekzistuese për përmbushjen e detyrave që ky sektor ka.

-Në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka një strukturë të posaçme e cila koordinoj veprimtaritë dhe të dhënat lidhur me dhunën në familje. Theksojmë se Ministria e Drejtësisë në këtë drejtim ka dhe institucionet e saj të varësisë të cilat lidhen me këto raste si Ndhima Juridike falas, Përmbarimi Gjyqësor Shtetëror, Instituti i Mjekësisë Ligjore. Tashmë veprimtaritë lidhur me dhunën në familje përmbushen nga punonjës të cilët kryejnë funksione të tjera bazë.

Sistemi REVALB dhe hostimi i tij

Sistemi kryesor elektronik i cili duhet të përdoret nga strukturat për evidentimin e rastit të dhunës në familje është sistemi REVALB. Sipas të dhënave të MSHMS vendosja në funksion e tij është bërë prej vitit 2014. Në të duhet të regjistrohet çdo rast dhune, dhe të gjitha hapat që janë marrë për trajtimin e rastit sipas hallkave. Ky sistem për vetë sensitivitetin e të dhënave që mbart, përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve qendrorë dhe vendorë. Në bazë të popullimit që bëhet ky sistem prodhon statistika të rasteve në nivel bashkie por dhe kombëtar dhe i shërben unifikimit dhe uniformizimit të mbledhjes së të dhënave, me qëllim krijim e një databaze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave në lidhje me dhunën në familje. Mirëmbajtja, manualët dhe trajnimet e tij sipas MSHMS kryhet nga U.... J... P..... dhe në vitin 2021 është bërë përditësimi i tij fundit. Grupi i auditimit iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zyrtarisht me disa pyetje lidhur me sistemin, pronësinë, ndërveprimin, hostimin e tij. Në përgjigjen e saj zyrtare MSHMS pohon se, Sistemi REVALB nuk është aset i saj dhe gjendet i hostuar në një server virtual. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme MSHMS gjatë periudhës nën auditim nuk arriti të qartësonte pozicionin e saj lidhur me këtë sistem. Megjithatë ai është përdorur prej disa vitesh ai gjendet i përcaktuar vetëm në VKM nr. 327 datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen, rehabilitimin e viktimave të dhunës”.

1- Gjetje nga auditimi: Megjithatë numri i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare çdo vit arrin në rreth 5,000 raste, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe struktura e saj e varësisë Shërbimi Social Shtetëror nuk disponojnë ende një vlerësim të kapaciteteve akomoduese në rang kombëtar, për tu përgjigjur në kohë rasteve të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ndërkohë, kapacitetet shtetërore paraqiten mjaft të limituara me rreth 32 shtretërish të dedikuar në nivel kombëtar në qendrat rezidenciale dhe rreth 30 shtretër emergjence të disponueshëm në qendra multifunkionale, ku këto të fundit, ofrojnë akomodim dhe për problematika të tjera.

1. Konkluzioni: Mungesa e vlerësimit të kapaciteteve akomoduese nga ana e institucioneve përgjegjëse, krijon kufizime në hartimin e politikave të qarta, objektive dhe implementimin me sukses të tyre.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror, të kryej vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapaciteteve akomoduese shtetërore në vend dhe gjendjes së infrastrukturës ekzistuese, për të evidentuar në mënyrë të qartë dhe të plotë nevojat dhe alokuar në mënyrë të drejtë burimet për to.

Brenda datës 30.06.2024

2- Gjetje nga auditimi: Fondi Social, si një mekanizëm relativisht i ri, mbështetës për bashkitë e vendit, sa i përket financimit të qendrave të trajtimit të dhunës në familje, nuk ka arritur të implementohet në mënyrë efektshme, për të garantuar vazhdimësinë e tyre të mëtejshme nga këto njësi të vetëqeverisjes vendore. Megjithatë projektet parashikojnë kritere dhe standarde të parashikuara për një afat 3-vjeçar për ofrimin e shërbimeve, ato nuk arrijnë të përmbushen referuar aplikimeve të miratuara. Ndërkohë edhe financimet e kryera nëpërmjet Këshillave të Qarkut lidhur me dhunën në familje kanë evidentuar mangësi. Mangësitë konsistojnë kryesisht, në mungesën e planeve sociale rajonale të bashkërenduar me planet sociale të bashkive në territor, mos miratimi i kërkesave nga këshilli për projekte përpara paraqitjes së kërkesave për financim, mungesës së monitorimeve të vazhdueshme mbi dhënësit e shërbimit si dhe mungesa e raportimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike në MSHMS dhe SHSSH për shërbimin e kontraktuar, kjo për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe shpenzimin e fondeve në mënyrë efektive.

2. Konkluzioni: Numri i kufizuar i aplikimeve nga NJVQV-të për fondin social ka ndikime në cilësinë e projekteve, shtrirjen e tyre në territor si dhe qëndrueshmërinë e tyre në kohë.

2.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror të kryej një auditim të plotë për Fondin Social të realizuar sa i përket dhunës në familje për vitet ushtrimorë 2020 - 2023, duke u fokusuar tek përfituesit kryesorë të tij, me qëllim verifikimin financiar të pagesave të kryera dhe shërbimeve faktike të ofruara dhe rezultatet e tij ti paraqesë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Brenda datës 31.10.2024

2.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të bëjë miratimin e projekteve të financuara nga Fondi Social vetëm pasi ato të jenë të miratuara më parë nga Këshilli i Qarkut së bashku me planet sociale rajonale të bashkërenduar me bashkitë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3- Gjetje nga auditimi: Bonusi i qirasë për viktimat e dhunës në familje gjendet në nivele minimale. Kështu në bashkitë e audituara, konkretisht në Bashkitë Durrës, dhe Gjirokastrë, evidentohen mesatarisht 2 deri në 3 përfitues në vit. Në Bashkinë Kukës mbështetja me bonus qiraje është ofruar nga organizatat jofitimprurëse, ndërkohë që kjo bashki nuk ka kryer asnjë pagesë për këtë kategori. Sa i përket strehimit, situata mbetet thuajse njëlloj ku Bashkia Durrës paraqitet me 4 raste strehimi social, ajo Gjirokastrë me 2 raste, ndërsa Bashkia Kukës pa asnjë rast të subvencionuar. Nivelet e ulëta të mbështetjes financiare nga këto njësi të vetëqeverisjes vendore jo pak të rëndësishme nga niveli i popullsisë dhe rasteve të regjistruara, paraqesin nevojën për një fokus më të qartë të tyre drejt grave, viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

3. Konkluzioni: Mbështetja financiare e kufizuar nga ana e NJVQV-ve lidhur me bonusin e qirasë dhe strehimin social ka ndikime të rëndësishme për rehabilitimin social të viktimave të dhunës.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kukës, Gjirokastrë dhe Durrës gjatë hartimit të projektbuxheteve vendore bazuar në numrin e aplikimeve për bonus qiraje të grave viktimave të dhunës në familje dhe problematikave sociale të territorit që mbulojnë, të marrin në konsideratë rritjen e numrit të subvencionimeve me bonus qiraje për këtë kategori.

Menjëherë dhe në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Qendrat shtetërore të ofrimit të shërbimeve për dhunën në familje, si ato të emergjencës ashtu edhe ato rezidenciale, nuk rezultojnë të licencuara referuar kategorisë përkatëse të kuadrit ligjor që rregullon shërbimet komunitare dhe rezidenciale. Ky licencim duhet të kryhej rregullisht nëpërmjet QKB pas vlerësimit të përputhshmërisë së kriterëve dhe situatës në vend nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Mungesa e licencimeve të qendrave shtetërore mbart risk jo vetëm mbi përmbushjen e kriterëve të akomodimit dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e tyre, por gjithashtu krijon një model aspak pozitiv për shoqatat apo dhe organizatat partnere të cilat ofrojnë shërbime dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje.

4. Konkluzioni: Moskryerja e licencimit të qendrave të cilat trajtojnë gratë e dhunuara nuk garanton dhënien e shërbimeve sipas standardeve të miratuara për ofrimin e tyre.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat e nevojshme që qendrat e ofrimit të shërbimeve për dhunën familje të pajisen me licencën përkatëse për ofrimin e shërbimeve, në zbatim të kuadrit ligjor për ofrimin e shërbimeve brenda standardeve, si dhe të trajtimit të barabartë të institucioneve publike me OJF dhe/ose ato private.

Menjëherë dhe në vijimësi

5- Gjetje nga auditimi: Sistemi REVALB i cili shërben për evidentimin e të dhënave të rasteve të dhunës në familje në rang kombëtar nuk është një aset i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila nuk dispononte gjithashtu informacion të mjaftueshëm lidhur me hostimin e tij. Ndërkohë që ky sistem mirëmbahet nga ekspertë jashtë MSHMS dhe përpunon të dhëna sensitive prej rreth 10 vitesh.

5. Konkluzioni: Mungesa e informacioneve nga ana e MSHMS mbi hostimin, mënyrën e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave të këtij sistemi rrit riskun për ekspozimit të të dhënave sensitive.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ti drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron, mbrojtjen e të dhënave personale, për vlerësimin e mënyrës së ruajtjes e përpunimit të të dhënave në këtë rast dhe garantuar mbrojtjen dhe përdorimin ligjor të tyre.

Menjëherë

6- Gjetje nga auditimi: Për periudhën nën auditim evidentohen mangësi lidhur me strukturat ekzistuese në institucionet qendrore, fushat e veprimit i të cilave lidhet me trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Konkretisht, strukturat e ngarkuara për politikat dhe barazinë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pas ristrukturimit të kryer

kanë pësuar ulje të numrit të stafit. Sektori përgjegjës në këtë ministri paraqitet me vetëm (1+2) punonjës duke patur në vijimësi pozicione vakante, megjithëse ky sektor ka detyra mjaft të rëndësishme si në drejtim të hartimit të politikave dhe zhvillimin e tyre, koordinimin e mekanizmit, adresimin e çështjeve të dhunës etj. Ndërkohë Ministria e Drejtësisë nuk disponon ende një strukturë të posaçme e cila të koordinojë veprimtaritë për dhunën në familje, por këto detyra i janë ngarkuar aktualisht punonjësve të cilët janë përgjegjës për funksione të tjera.

6. Konkluzioni: Mangësitë në strukturat e institucioneve kryesore të sistemit, që lidhen me dhunën mbi bazë gjinore dhe dhunën në familje ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre institucionale por dhe në monitorimin e proceseve të institucioneve të tyre të varësisë.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë të rishikojnë strukturat ekzistuese të cilat lidhen me çështjet të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, brenda kapaciteteve të tyre institucionale, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të ngarkuara dhe rritjen e efektivitetit të tyre në mekanizmin e ngritur.

Brenda datës 31.03.2024

Trajtimi i observacioneve të paraqitura nga subjektet nën auditim.

Në vijim të projektraportit të auditimit të përcjellë në subjektet e audituara, janë paraqitur observimet si më poshtë vijon:

Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror

- SHSSH me shkresën nr. 10186/1 prot, datë 07.12.2023, administruar në KLSH me nr. 442/20 prot, datë 07.12.2023, ka paraqitur sugjerime ku shprehet dakordësia mbi rekomandimet e lëna në funksion të rritjes së performancës së shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës. Gjithashtu për rekomandimin nr. 2.1 në faqen 65 të projektraportit, për kryerjen e një auditimi të plotë për Fondin Social sa i përket dhunës në familje, është kërkuar zgjatja e afatit nga data 31.03.2024 në datën 31.10.2024.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Nisur nga kërkesa e bërë dhe angazhimi i marrë pranohet kërkesa e bërë nga SHSSH dhe u bënë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

- DPPSH me shkresën nr. 6755/3 prot, datë 15.12.2023, administruar në KLSH me nr. 442/21 prot, datë 19.12.2023, është shprehur parimisht dakord me gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara në projektraport por ka paraqitur edhe disa komente/shpjegime lidhur me to dhe konkretisht: Lidhur me rekomandimin nr.4.1 faqe 27 e projektraportit, nga ana e DPPSH trajtohet zhvillimi i vazhdueshëm i trajnimeve lidhur me dhunën në familje, ku përcaktohen dhe institucionet me të cilat bashkëpunohet në këtë drejtim.

- Lidhur me rekomandimin nr.2.1 faqe 42 e projektraportit trajtohet se, në rastet e mos paraqitjes së KVDH gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të riskut mund të porositen strukturat vendore të policisë që ti përcjellin një kopje të tij KVDH në bashki.

- Lidhur me rekomandimin nr. 5.1 faqe 43 e projektraportit trajtohet se, nëse nevojiten shërbime psikologjike atëherë punonjësi i policisë dhe KVDH kontaktojnë psikologët e DVP-ve, të bashkive, shkollave, etj.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

- Lidhur me komentet mbi rekomandimin nr. 4.1, grupi i auditimit evidenton hapa të marrë për kryerjen e trajnimeve të targetuara por thekson nevojën për identifikimin e zonave me risk të

lartë për këtë tipologji kriminaliteti dhe përshpejtimin e organizimit të programeve trajnuese sipas këtyre zonave. Sa më sipër nuk vlerësohet i nevojshëm ndryshimi i rekomandimit.

- Lidhur me komentet mbi rekomandimin nr. 2.1 theksojmë se, rekomandimi i dhënë i përshtatet nevojës të cilën edhe ju citoni.

- Sa i përket rekomandimit nr. 5.1 theksojmë se, grupi i auditimit, nisur nga ndjeshmëria e problematikës, trajtimin të përshtatshëm dhe me dinjitet të viktimës, mbështetjes psikologjike të tyre në momentet e para të trajtimit të rastit, por edhe nga vlerësimet e aktorëve të tjerë të përfshirë në proces, gjykon si element thelbësor përfshirjen e mbështetjes psikologjike që në fazën fillestare. Sa më sipër nuk vlerësohet i nevojshëm ndryshimi i rekomandimit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- MSHMS me shkresën nr. 2006/5 prot, datë 15.12.2023, administruar në KLSH me nr. 442/22 prot, datë 20.12.2023, ka shprehur dakordësi për gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në projektraport, si dhe ka kërkuar rishikimin e afateve për disa rekomandime. Konkretisht është kërkuar rishikimi i afateve për rekomandimet nr. 5.1 faqe 43 , nr. 1.1 faqe 53, nr. 2.2 faqe 65, nr. 5.1 faqe 66 të projektraportit të auditimit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Lidhur me kërkesën për ndryshimin e afateve të rekomandimeve, grupi i auditimit referuar shpjegimeve dhe angazhimit të marrë nga ana e MSHMS pranon rishikimin e afateve për rekomandimet nr. 5.1 faqe 43 dhe nr. 1.1 faqe 53 dhe ka reflektuar ndryshimet në Raportin e Auditimit.

Lidhur me rekomandimin nr. 2.2 faqe 65 duke qenë se rekomandimi ka të bëjë me një kërkesë nga baza ligjore aktuale, implementimi i rekomandimit është i detyrueshëm për tu zbatuar menjëherë dhe në vijimësi, dhe për këtë arsye kërkesa nuk pranohet.

Lidhur me rekomandimin nr. 5.1 faqe 66 nuk vlerësohet që është i nevojshëm rishikimi i afatit pasi rekomandimi ka të bëjë vetëm me dërgimin e kërkesës drejt Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vlerësimin e mënyrës së ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale në sistemin REVALB, referuar rekomandimit të KLSH.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT